

# LIGJ PËR MENAXHIM ME PAJISJE ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE DHE ME PAJISJE ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE TË HEDHUR

TEKST I KONSOLIDUAR [\[1\]](#)

**Teksti në  
gjuhën  
Maqedonase**

Закон за  
управувања со  
електрична и  
електронска опрема  
и отпадна  
електрична и  
електронска опрема

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Lënda e rregullimit

Me këtë ligj rregullohen kërkesat për mbrojtjen e mjedisit jetësor që duhet t'i plotësojnë personat juridikë dhe fizikë që prodhojnë dhe lëshojnë në treg në Republikën e Maqedonisë pajisje elektrike dhe elektronike dhe që veprojnë me pajisje elektrike dhe elektronike të hedhur, si dhe subjektet tjera që marrin pjesë në procedurat e prodhimit dhe lëshimit në treg të pajisjes elektrike dhe elektronike, kufizimi i përdorimit të substancave të caktuara të rrezikshme në prodhimin e pajisjes elektrike dhe elektronike, mënyra e grumbullimit, trajtimit, përpunimit dhe mënjanimit të pajisjes elektrike dhe elektronike të hedhur, si dhe çështje tjera për menaxhim me pajisje elektrike dhe elektronike të hedhur.

### Neni 2

#### Zbatimi subsidiar i ligjeve tjera

(1) Për çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e veprimit me hedhurinat e rrezikshme të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ligj, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e rregullave nga sfera e menaxhimit me hedhurina.

(2) Për rregullimin e çështjeve lidhur me qasjen në informatat të cilat kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, pjesëmarrjen e publikut në miratimin e vendimeve, vlerësimin e ndikimit nga strategjitet e caktuara, planet dhe programet mbi mjedisin jetësor, vlerësimin e ndikimeve nga projektet e caktuara mbi mjedisin jetësor, zbatohen dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(3) Në procedurat e përcaktuara me këtë ligj zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

### Neni 3

#### Qëllimet e ligjit

(1) Qëllimet themelore të këtij ligji janë:

- zvogëlimi deri në nivelin më të vogël të mundshëm të ndikimit negativ të

pajisjes elektrike dhe elektronike të hedhur mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve dhe

- avancimi i standardeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga prodhuesit, tregtarët dhe shfrytëzuesit e fundit gjatë ciklit jetësor të prodhimeve, e sidomos gjatë trajtimit, përpunimit dhe mënjanimit të pajisjes elektrike dhe elektronike të hedhur.

(2) Krahas qëllimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, në pajtim me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm me këtë ligj duhet të arrihen edhe qëllimet në vijim:

- pengimi i krijimit dhe hedhja e pajisjes elektrike dhe elektronike të hedhur,
- arritja e nivelit të lartë të rishfrytëzimit, riciklimit dhe llojeve tjera të përpunimit të pajisjes elektrike dhe elektronike të hedhur, si dhe zvogëlimi i mënjanimit të pajisjes elektrike dhe elektronike të hedhur në deponi,
- sigurimi i kushteve për themelin e zhvillimin e tregut të rishfrytëzimit, riciklimit dhe mënyrave tjera të përpunimit të pajisjes së hedhur elektrike dhe elektronike dhe
- sigurimi i pozitës së barabartë në treg të personave juridikë dhe fizikë të vendit dhe të huaj dhe shmangia dhe mënjanimi i barrierave tregtare që mund ta çrregullojnë tregun me pajisje elektrike dhe elektronike

## Neni 4

### Zbatimi i ligjit

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen për këto kategori të pajisjeve elektrike dhe elektronike (në tekstin e mëtejmë: kategori të pajisjes):

- 1) aparate të mëdha të ekonomisë familjare;
- 2) aparate të vogla të ekonomisë familjare;
- 3) pajisje për teknologji informatike dhe telekomunikim;
- 4) pajisje për konsum të gjerë dhe elektronikë argëtuese;
- 5) pajisje për ndriçim;
- 6) aparate elektrike dhe elektronike (përveç mjeteve të mëdha industriale të palëvizshme);
- 7) lodra elektrike dhe elektronike dhe pajisje për argëtim dhe sport;
- 8) aparate mjekësore (përveç aparateve që mund të shkaktojnë radiacion apo infeksion);
- 9) instrumente për ndjekje dhe kontroll dhe
- 10) automate.

(2) Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për lloje të veçanta të prodhimeve të sistemuara në Listën e llojeve të prodhimeve nga neni 41 paragrafi (4) i këtij ligji, që bëjnë pjesë në kategoritë e pajisjes elektrike dhe elektronike nga paragrafi (1) i këtij neni (në tekstin e mëtejmë: lloje të pajisjes).

(3) Dispozitat e këtij ligji nuk e përjashtojnë zbatimin e rregullave të cilat kanë të bëjnë me sigurinë, mbrojtjen shëndetësore, mbrojtjen sanitare-higjenike dhe të rregullave për menaxhim me hedhurina.

(4) Të gjitha masat, standardet dhe qëllimet që janë përcaktuar me këtë ligj zbatohen si kërkesa minimale të cilat duhet të plotësohen gjatë menaxhimit me pajisje elektrike dhe elektronike.

(5) Nëse me ligj tjetër janë përcaktuar masa dhe standarde të mjedisit jetësor, gjatë menaxhimit me pajisje elektrike dhe elektronike zbatohen masat më rigorozë dhe standardet me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe arritjes së qëllimeve të mjedisit jetësor.

## Neni 5

### Përjashtim nga zbatimi i ligjit

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për:

- 1) pajisje elektrike dhe elektronike që është pjesë përbërëse e një lloji tjetër të pajisjes që nuk bën pjesë në kategoritë e pajisjes elektrike dhe elektronike nga nen 4 paragrafi (1) i këtij ligji;
- 2) tonerë të hedhur printimi të sistemuar në Listën e llojeve të hedhurinave në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina, nëse krijoen si material i shpenzuar gjatë shfrytëzimit të printerëve, dhe
- 3) pajisje elektrike dhe elektronike që shfrytëzohet si pajisje e cila është e dedikuar për shfrytëzim në mbrojtjen e vendit, armë, municion dhe material ushtarak, me përjashtim të prodhimeve të cilat nuk janë të dedikuara për qëllime konkrete ushtarake.

## Neni 6

### Definizione

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë domethënien në vijim:

1. "Pajisje elektrike dhe elektronike" është pajisja, puna e rregullt e së cilës varet nga rryma elektrike ose nga fushat elektromagnetike, si dhe pajisja që është e dedikuar për prodhimin, përcimin dhe matjen e atyre rrymave ose fushave të klasifikuara në njérën nga kategoritë nga nen 4 paragrafi (1) i këtij ligji dhe është e dedikuar për përdorim nën tension i cili nuk është më i madh se 1000 volt për rrymë alternative dhe 1500 volt për rrymë njëkahëshe (në tekstin e mëtejmë: pajisje);
2. "Pajisje e hedhur elektrike dhe elektronike" është hedhurinë nga pajisjet elektrike dhe elektronike në pajtim me dispozitat e Ligjit për menaxhim me hedhurina, duke i përfshirë të gjitha pjesët përbërëse, nënëmontimet dhe materialet dhe pjesët konsumuese të cilat janë pjesë e prodhimit në momentin e hedhjes (në tekstin e mëtejmë: pajisje e hedhur);
3. "Pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare" është pajisja e hedhur që krijohet në ekonomitë familjare, si dhe pajisja e hedhur që krijohet në industri, veprimtaritë zejtare, shërbyese dhe veprimtaritë tjera, e cila sipas llojit dhe sasisë është e ngjashme me pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare;
4. "Pajisje e hedhur e cila nuk është pajisje e ekonomive familjare" është pajisja e hedhur që krijohet nga pajisja e cila bën pjesë në Listën e llojeve të prodhimeve nga nen 41 paragrafi (4) i këtij ligji, dhe që nuk përdoret në ekonomitë familjare;
5. "Pengim" janë masat e orientuara për zvogëlimin e sasive të pajisjes së hedhur dhe ndikimeve të dëmshme mbi mjedisin jetësor, që shkaktohen nga pajisja e hedhur, si dhe nga materialet dhe substancat e përbajtura në atë pajisje;
6. "Rishfrytëzim" është çdo procedurë në të cilën pajisja e hedhur ose pjesët përbërëse të saj shfrytëzohen për qëllim të njëjtë për çka edhe janë bërë, duke e përfshirë edhe përdorimin e mëtejmë të pajisjes ose të pjesëve përbërëse të saj që kthehen te tregtarët, në vendet e grumbullimit, qendrat e grumbullimit, në instalimet për riciklim të pajisjes së hedhur ose te prodhuesit;
7. "Riciklim" është çdo procedurë e rishfrytëzimit të materialeve të hedhura në procesin prodhues për dedikim fillestar ose për dedikime tjera, përveç për përpunim energjetik, me ç'rast me përpunim energjetik nënkuqtohet përdorimi i hedhurinave djegëse si mjet për prodhimin e energjisë me djegie të drejtpërdrejtë me hedhurinë tjetër ose pa hedhurinë tjetër, por me fitimin e nxehësisë;
8. "Përpunim" është çdo procedurë e përpunimit të hedhurinës në pajtim me nenin 29 të Ligjit për menaxhim me hedhurina, e cila është e zbatueshme ose mund të zbatohet për përpunimin e pajisjes së hedhur;

9. "Mënjanim" është çdo procedurë për mënjanimin e hedhurinës në pajtim me nenin 35 të Ligjit për menaxhim me hedhurina, e cila është e zbatueshme ose mund të zbatohet për mënjanimin e pajisjes së hedhur;

10. "Trajtim" është çdo procedurë që ndërmerret pas dorëzimit të pajisjes së hedhur në instalimin për trajtim për pengimin e ndotjes, çmontim, imtësim, përpunim ose përgatitje për mënjanim, si dhe çdo procedurë tjetër që zbatohet për përpunimin dhe/ose për mënjanimin e pajisjes së hedhur;

11. "Lëshim i pajisjes në treg" është:

- dhënia e pajisjes së prodhuar për herë të parë në përdorim shfrytëzuesit të fundit ose tregtarit për shitje të mëtejme,
- importi i pajisjes në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë tregtare për importin e pajisjes me dedikim për dhënie të pajisjes së importuar tregtarit për shitje të mëtejme ose dhënie të pajisjes së importuar për shfrytëzim shfrytëzuesit të fundit ose
- importi i pajisjes për kryerjen e veprimtarive që nuk paraqesin veprimtari tregtare për import të pajisjes;

12. "Vend i grumbullimit" është vendi në objekt ose hapësirë në objekt ose hapësirë tjetër e mbuluar, që i shfrytëzon prodhuesi ose në emër të tij personi i tretë, e rregulluar për grumbullimin veç e veç të pajisjes së hedhur, magazinimin e përkohshëm dhe/ose klasifikimin, si dhe aktivitetet tjera të lidhura para dorëzimit të saj për trajtim, përkatësisht përpunim;

13. "Qendër e grumbullimit" është hapësira e rregulluar për grumbullim dhe magazinim të përkohshëm të llojeve, përkatësisht të fraksioneve të grumbulluara në veçanti të hedhurinave komunale;

14. "Prodhues" është personi juridik ose fizik i cili pa marrë parasysh mënyrën e përdorur të shitjes, duke e përfshirë edhe shitjen nëpërmjet komunikimit në largësi në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet mbrojtja e konsumatorëve:

- prodhon dhe shet pajisje me markë të vet tregtare,
- rishet, me markë të vet tregtare, pajisje të prodhuar nga prodhuesi tjetër, me ç'rast rishitësi nuk konsiderohet si prodhues nëse marka e prodhuesit burimor është shënuar në pajisje, siç parashihet në alinenë 1 të kësaj pike ose
- për kryerjen e veprimtarisë së vet importon pajisje për lëshim në treg në Republikën e Maqedonisë ose eksporton pajisje jashtë saj. Si prodhues nuk do të konsiderohet personi i cili siguron vetëm përkrahje financiare sipas, apo në pajtim me çfarëdo marrëveshje financiare dhe që nuk vepron edhe si prodhues sipas alineve 1, 2 dhe 3 të kësaj pike. Nëse pajisja nuk është prodhuar në Republikën e Maqedonisë, e lëshohet në treg sipas alineve 1, 2 dhe 3 të kësaj pike, atëherë si prodhues do të konsiderohet përfaqësuesi i tij në Republikën e Maqedonisë. Si prodhues do të konsiderohet edhe personi juridik ose fizik i cili si shfrytëzues i fundit për nevoja të veta ka importuar pajisje pa ndërmjetësues;

15. "Tregtar" është personi juridik ose fizik i cili siguron furnizim të pajisjes për shfrytëzuesin e fundit, si veprimtari komerciale. Si tregtar do të konsiderohet edhe prodhuesi, nëse pajisjen e prodhuar ose të importuar ia siguron drejtpërdrejt shfrytëzuesit të fundit;

16. "Posedues" është personi juridik ose fizik i cili ka shfrytëzuar, shfrytëzon ose ka për qëllim të shfrytëzojë pajisje, përkatësisht personi i cili me kryerjen e veprimtarisë së vet në mënyrë permanente ose përkohësisht krijon pajisje të hedhura, ndërsa si posedues, sipas këtij ligji, nuk konsiderohen qytetarët apo ekonomitë familjare;

17. "Shfrytëzues i fundit" është konsumatori i cili për shkak të përdorimit përfundimtar ose shfrytëzimit të prodhimit tjetër, shfrytëzon pajisje, dhe në atë mënyrë, pas harxhimit të tyre, krijon pajisje të hedhur. Si shfrytëzues i fundit do të konsiderohet poseduesi apo tregtari i cili për nevojat e veta ka importuar pajisje pa ndërmjetësues;

18. "Prodhues i vogël" është personi juridik ose fizik i cili lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë, pajisje në sasi jo më të mëdha se ato të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji;
19. "Veprues kolektiv" është personi juridik i themeluar nga prodhuesit me qëllim të përbushjes së obligimeve nga neni 21 i këtij ligji, i cili ka marrë leje për veprim me pajisje të hedhur në pajtim me nenin 28 të këtij ligji dhe i cili fitimin e realizuar e shfrytëzon për përbushjen e obligimeve nga neni 21 i këtij ligji;
20. "Veprues i pavarur" është personi juridik ose fizik i cili ka marrë leje për veprim të pavarur me pajisje të hedhur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji;
21. "Marrëveshje financiare" është çdo marrëveshje ose aranzhman për kredi, qira (lizing), hua ose për shitje me pagesë të prolonguar që ka të bëjë me cilëndo pajisje, pa marrë parasysh nëse kushtet nga ajo marrëveshje ose aranzhmani ose nga cilado marrëveshje ose aranzhman me peng parashohin ose nuk parashohin se do të vijë ose se mund të vijë deri në bartjen e pronësisë mbi atë pajisje;
22. "Grumbullues i autorizuar i hedhurinës" (në tekstin e mëtejmë: grumbullues i autorizuar) është ndermarrja komunale ose personi tjetër juridik ose fizik i cili është i autorizuar për grumbullimin dhe transportin e pajisjes komunale në rajonin e komunës, në komunat e qytetit të Shkupit ose në Qytetin e Shkupit;
23. "Substancë ose masë e rrezikshme" (në tekstin e mëtejmë: substancë) është çdo substancë ose çdo masë që konsiderohet si e rrezikshme në pajtim me rregullat për kimikale;
24. "Pajisje e hedhur e mbetur" është ngarkesa e mjedisit jetësor për shkak të krijimit të pajisjes së hedhur nga pajisja që është lëshuar në treg para 1 janarit 2013 (në tekstin e mëtejmë: hedhurinë e mbetur);
25. "Organ për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor" është Drejtoria e Mjedisit Jetësor, organ në përbërje të Ministrisë së Mjedisit jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejmë: organ profesional);
26. "Person tjetër juridik i pavarur" është personi juridik i regjistruar për kryerjen e shërbimeve profesionale, teknike dhe shërbimeve konsultuese nga sfera e ekonomisë dhe mjedisit jetësor;
27. "Operator ekonomik" është personi juridik ose fizik i cili gjatë kryerjes së veprimitarisë së vet gjatë menaxhimit me pajisje mund jetë prodhues, tregtar dhe posedues dhe
28. "Marrëveshje vullnetare" është marrëveshja formale e cila ka klauzola përmbaruese, e lidhur ndërmjet organeve të pushtetit shtetëror dhe lokal nga njëra anë dhe organizatave të cilat përfaqësojnë interesa të caktuara të sektorëve ekonomikë ose grupi të operatorëve ekonomikë të përfshirë me këtë ligj nga ana tjetër, me qëllim që të arrihen qëllimet e këtij ligji, si dhe të arrihen kushtet e përcaktuara në marrëveshje.

## Neni 7

### Parimet

- (1) Në pajtim me qëllimet për mbrojtje afatgjate dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe mbrojtjen dhe avancimin e medieve dhe sferave të mjedisit jetësor, menaxhimi me pajisje bazohet në:
  - 1) parimin e përgjegjësisë së prodhuesit, sipas të cilët prodhuesi është përgjegjës për marrjen e masave për menaxhim me pajisjen me qëllim që të eliminohet dhe/ose të zvogëlohet deri në masën e fundit të mundshme ndikimi negativ mbi mediet dhe sferat e mjedisit jetësor që shkaktohet si

rezultat i pajisjes së hedhur të krijuar nga veprimitaria e vet, duke përfshirë edhe krijimin e kushteve për realizimin në shkallë të lartë të grumbullimit veç e veç, rishfrytëzimit, riciklimit dhe përpunimit në mënyrë tjetër të pajisjes së hedhur dhe

2) parimin e vlerësimit të ciklit jetësor të prodhimit, sipas të cilët prodhuesi i pajisjes detyrohet që të kryejë vlerësim të ciklit jetësor të pajisjes në mënyrë me të cilën do të mundësohet rritja e realizimeve ekologjike të pajisjes, përashtimi ose zvogëlimi i pjesëmarrjes së substancave të dëmshme në pajisje në pajtim me arritjet teknike-shkencore, dizajnimi në mënyrë që do të kontribuojë në zvogëlimin e hedhurinës që krijohet nga pajisja e hedhur me qëllim të pengimit të ndikimeve negative mbi mediet dhe sferat e mjedisit jetësor.

(2) Në menaxhimin me pajisjen, krahas parimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, në mënyrë adekuate zbatohen edhe parimet e përcaktuara në Ligjin për mjedisin jetësor dhe në Ligjin për menaxhim me hedhurinë.

## II. KËRKESA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

### **Neni 8**

#### **Dizajnimi i pajisjes**

(1) Pajisja duhet të projektohet dhe prodhohet në mënyrë me të cilën do të sigurohet:

- 1) zvogëlim i përdorimit të substancave të rrezikshme në masë më të vogël të mundshme dhe
- 2) zbërthim dhe çmontim i lehtësuar, rishfrytëzim dhe riciklim dhe mënyrë tjetër e përpunimit të pajisjes së hedhur, pjesëve të tyre përbërëse dhe materialeve të montuara.

(2) Prodhesit nuk guxojnë që me dizajn të veçantë të pajisjes, pjesëve të tyre përbërëse dhe materialeve të montuara ose me procedurat e prodhimit ta pengojnë rishfrytëzimin e pajisjes, përvèc nëse ai dizajn ose ato procedura të prodhimit përfshijnë përparësi të konsiderueshme për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe/ose siguri gjatë shfrytëzimit të pajisjes.

### **Neni 9**

#### **Ndalim për shfrytëzimin e substancave të rrezikshme në pajisje**

(1) Ndalohet lëshimi në treg në Republikën e Maqedonisë i pajisjeve nga kategoritë nga neni 4 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 10 të këtij ligji, duke i përfshirë edhe poçet elektrike dhe burimet tjera të dedikuara për ndriçimin e ekonomive familjare, që përmban: plumb, zhivë, kadmium, krom gjashtëivalent Cr+, difenile të polibromuara (PHB) ose difeniletre të polibromuara (PCH).

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk kanë të bëjnë me pjesët rezervë të dedikuara për rregullime ose rishfrytëzim të pajisjes së lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë, para fillimit të zbatimit të këtij ligji, si dhe të burimeve fluoreshente dhe burimeve tjera për ndriçimin e materialeve të cilat bëjnë pjesë në listën e pajisjeve nga paragrafi (3) i këtij neni.

(3) Lista e pajisjeve me të cilën nuk kanë të bëjnë masat për ndalim dhe kufizime nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe vlerat maksimale për koncentrimet e substancave të rrezikshme, afatet deri te të cilat lejohet pjesëmarrja e substancave të caktuara të rrezikshme në pajisje, pjesët dhe materialet përbërëse të saj i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

### III. OBLIGIMET E PËRGJITHSHME TË PRODHUESVE

#### **Neni 10**

##### **Shënimi i pajisjes**

(1) Me qëllim që të minimizohet deponimi i pajisjes së hedhur si hedhurinë komunale e paklasifikuar dhe të mundësohet grumbullimi i saj veç e veç, prodhuesi është i obliguar që në pajisjen të cilën e lëshon në treg, në vend të dukshëm të sigurojë shenjë qartë të dukshme, të lexueshme dhe të paraqitur në mënyrë të pashlyeshme për obligimin për grumbullimin veç e veç të pajisjes së hedhur.

(2) Formën dhe përbajtjen e shenjës nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Nëse shenja nga paragrafi (1) i këtij ligji nuk mund të shtypet në vetë pajisjen, për shkak të madhësisë ose përdorimit të saj specifik, atëherë ajo vendoset në paketimin, në udhëzimin për përdorim ose në fletëgarancinë e asaj pajisjeje.

(4) Emri i prodhuesit medoemos duhet të duket qartë në mbishkrimin e përforcuar në pajisje.

(5) Mbishkrimi nga paragrafi (4) i këtij neni medoemos duhet të paraqitet në mënyrë me të cilën shihet emri i prodhuesit dhe të dhëna kur pajisja është lëshuar në treg.

#### **Neni 11**

##### **Informata për shfrytëzuesit e fundit**

(1) Prodhesi është i obliguar që, në llogari të vet, t'i informojë shfrytëzuesit e fundit të pajisjeve nga ekonomitë familjare për:

- ndalimin për lënien e pajisjes së hedhur si hedhurinë komunale të paklasifikuar dhe për obligimin për grumbullimin veç e veç të pajisjes së hedhur,
- sistemet e vendosura për marrjen dhe grumbullimin e pajisjes së hedhur të cilat i kanë në diskonim,
- mënyrën e kontributit të tyre për rishfrytëzim, riciklim dhe mënyrë tjetër të përpunimit,
- ndikimet e mundshme negative dhe pasojat mbi shëndetin e njerëzve dhe mjedisin jetësor si rezultat i prezencës së substancave të rrezikshme në pajisje dhe
- domethënien e shenjës nga neni 10 i këtij ligji.

(2) Informatat nga paragrafi (1) i këtij neni, bashkëngjiten në/ose me udhëzimin për përdorim të pajisjes kur i dërgohet shfrytëzuesit të fundit.

(3) Prodhesi është i obliguar që në mënyrë adekuat t'i informojë dhe njoftojë tregtarët për mënyrën e marrjes së pajisjes së hedhur nga shfrytëzuesit e fundit dhe të gjithë distributorët në zinxhirin e dërgimit të pajisjes, dhe para së gjithash tregtarin i cili i fundit ia dërgon pajisjen shfrytëzuesit të fundit.

(4) Si mënyrë adekuat e informimit nga paragrafi (3) i këtij neni mund të konsiderohet edhe mënyra e informimit nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Prodhesi dhe tregtari janë të obliguar që të sigurojnë që në vendet e shitjes në vend të dukshëm të vendoset njoftimi për shfrytëzuesin e fundit, për mënyrën dhe për vendet për marrjen e pajisjes së hedhur.

#### **Neni 12**

## **Informata për operatorët e instalimeve për trajtim**

(1) Që të mundësohet rishfrytëzimi i pajisjes së hedhur dhe trajtimi i sigurt për mjedisin jetësor, duke përfshirë edhe ruajtjen, rregullimet dhe riciklimin, prodhuesi është i obliguar që për operatorët e instalimeve për rishfrytëzim, instalimeve për trajtim dhe riciklim të pajisjes së hedhur, të sigurojë informata për:

- mundësitet për rishfrytëzim dhe trajtim, për çdo kategori të pajisjes së re,
- pjesët e ndryshme përbërëse dhe materialet e pajisjes së hedhur dhe
- vendet ku në pajisjen e hedhur gjenden substancat e rrezikshme.

(2) Informatat nga paragrafi (1) i këtij neni, prodhuesi është i obliguar t'i sigurojë për çdo kategori të pajisjes së re më së voni në afat prej 12 muajsh nga dita e lëshimit në treg të pajisjes.

(3) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni, prodhuesi i dorëzon në formë të doracakut të shtypur ose nëpërmjet shërbimeve të internetit ose në formë elektronike.

## **Neni 13**

### **Regjistrimi i prodhuesve**

(1) Prodhesit të cilët për herë të parë lëshojnë në treg ose importojnë si shfrytëzues të fundit në Republikën e Maqedonisë pajisje, janë të obliguar të regjistrohen për këtë në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Regjistrimi kryhet me dorëzimin e kërkesës për regjistrim, nga prodhuesi, në organin profesional, që i përmban këto të dhëna:

- 1) emrin e prodhesit dhe markën tregtare (nëse e ka), të cilën prodhuesi e shfrytëzon gjatë kryerjes së veprimitarisë së vet;
- 2) adresën e prodhesit: numrin postar dhe selinë, rrugën dhe numrin, ueb-adresën, numrin e telefonit dhe adresën elektronike, si dhe personin për kontakt;
- 3) emrin dhe kategorinë e pajisjes që e lëshon në treg;
- 4) informata për mënyrën në të cilën prodhuesi i përmbush ose do t'i përmbushë obligimet që dalin nga ky ligj (veprim i pavarur ose kolektiv);
- 5) numrin unik të subjektit afarist dhe numrin tatimor;
- 6) regjistrimin e prodhesit dhe
- 7) deklaratë në të cilën theksohet se informatat e paraqitura për regjistrim janë të vërteta.

(3) Organi profesional është i obliguar që të mbajë regjistër të prodhuesve që lëshojnë në treg pajisje, si dhe prodhime të cilat lëshohen në treg në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejmë: regjistër i prodhuesve)

(4) Në bazë të kërkesës nga paragrafi (2) i neni, organi profesional është i obliguar që në afat prej 30 ditësh t'i dorëzojë prodhuesit vërtetim për regjistrim në regjistrin nga paragrafi (3) i këtij neni.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton formën dhe përbajtjen e kërkesës për regjistrim nga paragrafi (2) i këtij neni, formën dhe përbajtjen e regjistrat nga paragrafi (3) i këtij neni, mënyrën e mbajtjes dhe ruajtjes së tij, si dhe formën dhe përbajtjen e vërtetimit nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Në rast të ndryshimit të të dhënave të dorëzuara gjatë regjistrimit nga paragrafi (2) i këtij neni, prodhuesi është i obliguar që në afat prej 30 ditëve nga dita e krijimit të ndryshimit, ta paraqesë ndryshimin e regjistrimit me dorëzimin e kërkesës për ndryshimin e të dhënave në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni. Në deklaratë dorëzohen informata vetëm për ato të dhëna që janë ndryshuar.

(7) Në rast kur prodhuesi do ta ndërpresë veprimtarinë e vet, përkatësish të lëshojë pajisje në treg në Republikën e Maqedonisë eshtë i obliguar që në afat prej 30 ditëve nga dita e ndërprerjes, të dorëzojë kërkesë për shlyerje nga regjistri nga paragrafi (3) i këtij neni, në organin profesional.

(8) Shlyerja nga regjistri nga paragrafi (3) i këtij neni kryhet edhe me propozim të inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor nëse konstatohet se nuk i përbush kërkesat e këtij ligji.

(9) Organi profesional eshtë i obliguar që në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës nga paragrafi (7) i këtij ligji, t'i dorëzojë prodhuesit vërtetim për shlyerje nga regjistri nga paragrafit (3) i këtij neni.

(10) Organi profesional eshtë i obliguar që në ueb faqen e vet ta shpallë dhe rregullisht ta azhurnojë Regjistrin nga paragrafi (3) i këtij neni.

## IV. VEPRIMI ME PAJISJE TË HEDHUR

### Neni 14

#### **Ndalimi për lënie**

Ndalohet që pajisja e hedhur të dorëzohet ose të lihet si hedhurinë e paklasifikuar komunale.

### Neni 15

#### **Obligime për shfrytëzuesit e fundit**

(1) Shfrytëzuesi i fundit eshtë i obliguar që pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare ta grumbullojë, ta ruajë dhe t'ia dorëzojë tregtarit ose grumbulluesit të autorizuar, si fraksion të grumbulluar në veçanti të hedhurinës komunale në qendrën e grumbullimit ose në vend për marrje, pune të cilën e siguron prodhuesi.

(2) Shfrytëzuesi i fundit eshtë i obliguar që pajisjen e hedhur e cila nuk eshtë pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare t'ia dorëzojë prodhuesit ose personit juridik ose fizik, i cili ka leje për veprim me hedhurinat, në pajtim me rregullat përmenaxhim me hedhurina.

(3) Shfrytëzuesi i fundit eshtë i obliguar që pajisjen e hedhur para se ta dorëzojë, ta grumbullojë ose ta ruaj në vend të veçantë, ashtu që të mos përzihet me lloj tjetër të hedhurinës, të mos imtësohet ose në mënyrë tjetër të asgjësohet, ose të ndotet me substancë të rrezikshme ose me substancë tjera, ashtu që rishfrytëzimi ose riciklimi i saj të pamundësohet.

(4) Nëse pajisja e hedhur përmban substancë dhe materiale të cilat para çmontimit të pajisjes së hedhur duhet të veçohen, shfrytëzuesi i fundit eshtë i obliguar të sigurojë që pajisja e hedhur të jetë në gjendje të tillë që veçimi i atyre substancave dhe materialeve të mund të realizohet në pajtim me rregullat e veçanta me të cilat rregullohet veprimi me ato substancë dhe materiale.

(5) Nëse pajisja e hedhur nga ekonomitë familjare eshtë aq e démtuar, sa që për shkak të substancave të rrezikshme të përbajtura në të, e rrezikon mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve ose eshtë pa pjesë përbërëse të rëndësishme, ose eshtë ndotur me lloj tjetër hedhurinash, shfrytëzuesi i fundit eshtë i obliguar që ta dorëzojë në qendrën e grumbullimit, si fraksion të veçuar të hedhurinës komunale.

### Neni 16

#### **Obligime për marrjen e pajisjes së hedhur nga**

## **ekonomitë familjare**

(1) Tregtari detyrohet që gjatë shitjes së pajisjes për ekonomi familjare, nga shfrytëzuesi i fundit falas ta marrë pajisjen e hedhur, nëse ai dëshiron që ta dorëzojë.

(2) Tregtari e kryen marrjen e pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare nëse bëhet fjalë për pajisje e cila sipas funksionit dhe klasifikimit të vet bën pjesë në kategoritë nga nen 4 paragrafi (1) i këtij ligji dhe është e barabartë me pajisjen e shitur, ndërsa numri i pjesëve të pajisjes së hedhur është i barabartë me numrin e pjesëve të pajisjes së shitur (sistemi një për një).

(3) Tregtari mund ta refuzojë marrjen e pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare nëse nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij nenit, ose pajisja nuk paraqet aparat të plotë, ose bëhet fjalë për pajisjen e hedhur nga nen 15 paragrafi (5) i këtij ligji.

### **Neni 17**

#### **Marrja e pajisjes së hedhur te tregtarët**

(1) Nëse tregtari nuk e merr pajisjen e hedhur drejtpërdrejt nga shfrytëzuesi i fundit gjatë dërgimit të pajisjes, është i obliguar të sigurojë që shfrytëzuesit e fundit gjatë blerjes së pajisjes të kenë mundësi për dorëzimin e pajisjes së hedhur falas në vendin e shitjes së pajisjes ose vend tjetër për marrje.

(2) Tregtari, me marrëveshje me prodhuesin, mund të sigurojë marrje të pajisjes së hedhur në vende për marrje, punë të cilën e siguron prodhuesi i cili e furnizon me pajisje.

(3) Si vend për marrjen e pajisjes së hedhur nga paragafi (1) i këtij nenit konsiderohen enët ose më shumë enë për pajisje të hedhura, të vendosura në hapësirë të myllur që është e rregulluar dhe ka madhësi të atillë që pajisja e hedhur të mos grumbullohet, dhe rregullimi i hapësirës të mundësojë marrje të papenguar të pajisjes së hedhur.

(4) Prodhesi pajisjen e hedhur e merr falas nga tregtari, ndërsa tregtari nga prodhuesi nuk guxon të kërkojë kompensim për marrjen e pajisjes së hedhur.

(5) Për vendet e marrjes nga paragafi (1) i këtij nenit, si dhe për pajisjen e hedhur të grumbulluar në suaza të hapësirës së vet afariste, tregtari nuk duhet të posedojë leje adekuate në pajtim me rregullat përmenaxhim me hedhurina.

### **Neni 18**

#### **Obligime për marrjen e pajisjes së hedhur që nuk është pajisje nga ekonomi familjare**

(1) Prodhesi detyrohet që me kërkesë të shfrytëzuesit të fundit falas ta marrë pajisjen e hedhur e cila nuk është pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare, dhe për atë të sigurojë veprim të mëtejmë, nëse pajisjen ia ka dërguar shfrytëzuesit të fundit.

(2) Pajisja e hedhur e mbetur që zëvendësohet me pajisje të re të njëjtë ose me pajisje të re e cila kryen funksion të njëjtë, mund të merret edhe në mënyrë, të cilën do ta kontraktojnë prodhuesi dhe shfrytëzuesi i fundit në momentin e blerjes së asaj pajisjeje, përkatësisht gjatë marrjes së saj kontraktojnë mënyrë tjetër të veprimit me pajisjen e hedhur, nëse nuk është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Për pajisjen tjetër të hedhur të mbetur për të cilën nuk është siguruar veprim në pajtim me paragrafët (1) dhe (2) të këtij nenit, shfrytëzuesi i

fundit është i obliguar të sigurojë grumbullim të ndarë dhe magazinim të përkohshëm, si dhe t'ia dorëzojë personit juridik ose fizik i cili ka leje adekuate për veprim me hedhurina në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina.

## Neni 19

### **Marrja e pajisjes së hedhur nga grumbulluesi i autorizuar**

(1) Prodhuesi në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet vepruesit kolektiv është i obliguar të sigurojë marrje të rregullt të pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare nga grumbulluesi i autorizuar, që ai e ka grumbulluar si fraksion të veçantë të grumbulluar të hedhurinës komunale.

(2) Grumbulluesi i autorizuar është i obliguar që t'ia dorëzojë pajisjen e hedhur të grumbulluar nga ekonomitë familjare vepruesit të pavarur ose kolektiv pa kërkesë për pagimin e vlerës së saj ose vlerës së pjesëve përbërëse të veçanta ose materialeve dhe substancave në pajisjen e hedhur.

(3) Për realizimin e obligimeve nga paragrafi (1) i këtij nenit vepruesi kolektiv dhe/ose vepruesi i pavarur dhe grumbulluesi i pavarur lidhin marrëveshje.

(4) Me marrëveshjen nga paragrafi (3) i këtij nenit, veçanërisht rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të palëve kontraktuese, mënyra për marrje të rregullt dhe pa pengesa të pajisjes së hedhur, mënyra e financimit dhe mbulimi i shpenzimeve të punës, si dhe çështje tjera me interes të përbashkët.

## Neni 20

### **Marrja, grumbullimi, transportimi dhe magazinimi i pajisjes së hedhur**

(1) Marrja e pajisjes së hedhur kryhet në vende të caktuara për marrjen e pajisjes së hedhur, të pajisura dhe të rregulluara në mënyrë që të mundësojë që shfrytëzuesit e fundit ta dorëzojnë ose ta lënë pajisjen e hedhur, në pajtim me këtë ligj.

(2) Transporti i mbledhur veç e veç i pajisjes së hedhur kryhet me mjete transportuese në mënyrë që do të mundësojë vëllim më të madh të rishfrytëzimit të aparateve të plota dhe rishfrytëzim të pjesëve të pajisjes, duke e përfshirë edhe përpunimin dhe riciklimin. Gjatë transportit të pajisjes së hedhur plotësohet dhe dorëzohet formular i transportit në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina.

(3) Grumbullimi i pajisjes së hedhur kryhet sipas kategorive, përkatësisht llojeve të pajisjes në vende për grumbullim dhe magazinim të përkohshëm, të pajisur dhe të rregulluar në mënyrë që do të mundësojë vëllim më të madh të rishfrytëzimit të aparateve të plota dhe rishfrytëzim të pjesëve të pajisjes, duke përfshirë edhe përpunimin dhe riciklimin.

(4) Pajisja e hedhur kur i dorëzohet grumbulluesit duhet të jetë në gjendje që shihet se nga ajo paraprakisht nuk janë mënjanuar pjesë nga pajisja e cila përbëhet prej më shumë tërësive.

(5) Si pajisje e hedhur nga paragrafi (3) i këtij nenit, konsiderohen edhe pjesët e ndara paraprakisht të pajisjes e cila përbëhet prej më shumë tërësive.

(6) Në vendet e grumbullimit dhe në qendrat e grumbullimit, pajisja e hedhur ruhet, përkatësisht nuk përzihet me ndonjë lloj tjetër të hedhurinave, dhe sistemohet sipas kategorive nga nenit 4 paragrafi (1) i këtij ligji që të mund të lehtësohet rishfrytëzimi i saj, përpunimi, riciklimi

ose mënjanimi.

(7) Pajisja e hedhur para trajtimit magazinohet në mënyrë që pengon të shtypet, thërrmohet, ose në mënyrë tjetër asgjësohet ose ndotet me materie të rrezikshme ose materie tjera, ashtu që rishfrytëzimi, riciklimi ose mënyra tjetër e përpunimit pamundësohet, përkatësisht të realizohet me shpenzime të larta të papërpjesëtueshme.

(8) Gjatë pranimit dhe dorëzimit të pajisjes së hedhur për ripërdorim si apartat i plotë, si dhe gjatë pranimit dhe dorëzimit për ripërdorim të pjesëve dhe materialeve nga pajisja e hedhur, të ndara gjatë trajtimit të pajisjes së hedhur plotësohet deklaratë për pranimin dhe dorëzimin e pajisjes së hedhur.

(9) Deklaratën nga paragrafi (8) i këtij neni, e plotësojnë personat fizikë dhe juridikë që kanë leje për magazinim, trajtim dhe/ose përpunim të pajisjes së hedhur.

(10) Deklaratën nga paragrafi (8) i këtij neni personat juridikë dhe fizikë nga paragrafi (9) i këtij neni janë të obliguar që ta ruajnë pesë vite duke llogaritur nga dita e dhënies së saj.

(11) Mënyrën e veprimit me deklaratën nga paragrafi (8) i këtij neni si dhe formën dhe përbajtjen e deklaratës për pranimin dhe dorëzimin e pajisjes së hedhur e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## Neni 21

### Obligime të prodhuesit

(1) Prodhuesi i pajisjes është i obliguar, me shpenzimin e vet, në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet vepruesit kolektiv, të sigurojë marrje, grumbullim ndaras, magazinim të përkohshëm, transport, trajtim, përpunim, rishfrytëzim dhe/ose riciklim dhe mënjanim të mbetjeve nga përpunimi i pajisjes së hedhur.

(2) Obligimet nga paragrafi (1) i këtij neni, prodhuesi është i obliguar që t'i realizojë me:

- grumbullimin falas të pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare, që tregtarët e marrin nga shfrytëzuesit e fundit,
- marrjen falas të pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare që në suaza të fraksioneve të grumbulluara ndaras të hedhurinave komunale e grumbullon grumbulluesi i autorizuar,
- dorëzimin e hedhurinave të grumbulluara në vendet e grumbullimit, në instalimet për trajtim, përpunim dhe mënjanim e mbetjeve nga përpunimi,
- plotësimin e qëllimeve për grumbullim nga neni 26 i këtij ligji, si dhe qëllimeve për përpunim nga neni 35 i këtij ligji dhe
- informimin e shfrytëzuesve të fundit nga neni 11 i këtij ligji.

(3) Prodhuesi i cili njëkohësisht është edhe shfrytëzues i fundit, është i obliguar me shpenzimet e veta t'i realizojë obligimet nga paragrafi (1) i këtij neni, për pajisje të cilën e ka prodhuar ose importuar në Republikën e Maqedonisë.

(4) Obligimet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohen për pajisjet që eksportohen.

(5) Obligimet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk kanë të bëjnë me prodhuesit e vegjël nga neni 24 i këtij ligji.

## Neni 22

### Shpenzimet për veprim me pajisjen e hedhur

(1) Sasitë e pajisjes së hedhur për të cilat secili prodhues i veçantë është i

obliguar të sigurojë financim të grumbullimit veç e veç, trajtim, përpunim, rishfrytëzim dhe/ose riciklim dhe mënjanim të mbetjeve nga përpunimi i pajisjes së hedhur medoemos duhet të jetë e barabartë me pjesën e cila i përgjigjet sasisë vjetore të pajisjes të cilën e ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë.

(2) Shpenzimet që i bart prodhuesi për veprim me pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare nuk paraqiten veçmas gjatë shitjes së pajisjes së re.

## Neni 23

### **Obligime të prodhuesit, poseduesit dhe/ose tregtarit si shfrytëzues të fundit**

(1) Prodhesi, poseduesi dhe/ose tregtar i cili për kryerjen e veprimtarisë së tij ose aktivitetit, vetë importon pajisje dhe për këtë nuk ka ndërmjetësues ose dorëzues paraprak në Republikën e Maqedonisë, dhe me këtë njëkohësisht është edhe shfrytëzues i fundit, detyrohet për pajisjen e hedhur që ai e krijon, të sigurojë veprim në këtë mënyrë:

- të lidhë marrëveshje me vepruesin kolektiv nga neni 28 i këtij ligji i cili në emër të tij dhe për llogari të tij do të sigurojë veprim të mëtutjeshëm me pajisjen e hedhur ose
- në mënyrë të pavarur të veprojë me pajisjen e hedhur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, tregtar i cili bën shitjen e pajisjes detyrohet për pajisjen të cilën e shet të sigurojë: - shënim në pajtim me nenin 10 të këtij ligji,

- deklaratë me shkrim nga personi juridik nga i cili blen pajisje ose ka lidhur marrëveshje me vepruesin kolektiv nga neni 28 i këtij ligji ose se ai person juridik është veprues i pavarur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji ose

- deklaratë me shkrim se pajisja buron nga personi juridik i cili është prodhues i vogël në pajtim me nenin 24 të këtij ligji.

## Neni 24

### **Lirim - prodhues i vogël**

(1) Prodhesi, i cili në nivel vjetor ka lëshuar në treg ose ka importuar në Republikën e Maqedonisë më pak ose baras me 1 000 kg pajisje elektrike ose më pak ose baras me 50 kg pajisje elektronike konsiderohet prodhues i vogël.

(2) Prodhesi nga paragrafi (1) i këtij neni detyrohet të regjistrohet në pajtim me nenin 13 të këtij ligji, si dhe të mbajë evidencë në pajtim me nenin 38 paragrafi (7) të këtij ligji.

(3) Në procedurën për regjistrim nga neni 13 i këtij ligji, prodhuesi i vogël detyrohet të kërkojë marrje të aktvendimit me të cilin do të përcaktohet si prodhues i vogël, duke theksuar me këtë rast sasinë e pajisjes të cilën për herë të parë ka për qëllim ta lëshojë në treg në Republikën e Maqedonisë.

(4) Aktvendimin nga paragrafi (3) i këtij neni e lëshon organi profesional.

(5) Organi profesional detyrohet në regjistrin nga neni 13 paragrafi (3) i këtij ligji, në mënyrë të veçantë t'i paraqesë prodhuesit për të cilët ka lëshuar aktvendim për prodhues të vogël.

(6) Prodhesi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk detyrohet të sigurojë veprim me pajisjen e hedhur nëse sasia e pajisjes që e ka lëshuar në treg ose e ka importuar si shfrytëzues i fundit, nuk i tejkalon sasitë në nivel vjetor të përcaktuara në paragrin (1) të këtij neni.

## Neni 25

## **Obligime të kryetarit të komunës**

(1) Kryetari i komunës, kryetari i komunave në qytetin e Shkupit dhe kryetari i qytetit të Shkupit, detyrohet të organizojë grumbullim ndaras të pajisjes së hedhur, të autorizojë grumbullues të pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare, si dhe të përcaktojë dhe organizojë vende ose lokacione për grumbullim ndaras të pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare, në qendra grumbulluese në gjithë rajonin e komunës, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, ku shfrytëzuesit e fundit pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare do të mund ta dorëzojnë falas.

(2) Gjatë përcaktimit të vendeve dhe lokacioneve në qendrat e grumbullimit duhet të merret parasysh numri i banoreve në vendbanim, me ç'rast duhet të sigurohet së pa- ku një qendër grumbulluese në nivel të komunës, përkatësisht, së paku nga një qendër grumbulluese për 30.000 banorë.

(3) Qendrat grumbulluese nga paragafi (2) i këtij neni, i përfshijnë edhe vendet ekzistuese dhe lokacionet për grumbullim të fraksioneve të ndara të grumbulluara të hedhurinave komunale, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara me këtë ligj ose ligj tjetër.

## **Neni 26**

### **Qëllimet për grumbullim**

(1) Në territorin e Republikës së Maqedonisë deri më 31 dhjetor 2020, duhet të grumbullohen së paku 4 kilogram në vjet për banor pajisje të hedhura nga ekonomitë familjare.

(2) Sasitë e eksportuara të pajisjeve në territorin e Republikës së Maqedonisë nuk do të përllogariten në sasitë nga paragafi (1) i këtij ligji.

(3) Sasitë e pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare në kilogramë, që çdo prodhues i veçantë detyrohet t'i grumbullojë në vitin rrjedhës për arritjen e qëllimeve nga paragafi (1) i këtij neni është e barabartë me pjesën e cila i përgjigjet sasisë vjetore të pajisjes nga ekonomitë familjare të cilën e ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë në vitin paraprak në raport me sasinë për të cilën janë përgjegjës të gjithë prodhuesit të cilët kanë lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë pajisje nga ekonomitë familjare në vitin paraprak.

(4) Për arritjen e qëllimeve nga paragafi (1) i këtij neni, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton qëllimet vjetore për grumbullim për vitin e ardhshëm në pajtim me programin nga neni 43 i këtij ligji, më së voni deri më 15 dhjetor në vitin paraprak.

(5) Organi profesional e përcjell realizimin e sasive të grumbullimit në bazë vjetore në bazë të të dhënave të marra në pajtim me nenet 38 dhe 39 të këtij ligji.

## **Neni 27**

### **Veprimi kolektiv me pajisje të hedhur**

(1) Plotësimin e detyrimeve nga neni 21 I këtij ligji, prodhuesit mund t'i realizojnë në mënyrë të pavarur ose me lidhjen e marrëveshjes së veçantë për marrjen e detyrimeve për veprim me pajisje të hedhur me vepruesin kolektiv, i cili në pajtim me këtë ligj, është i autorizuar për veprim me pajisje të hedhur në emër të tij dhe për llogari të tij.

(2) Për zbatimin e detyrimeve nga paragafi (1) i këtij neni, vepruesi kolektiv detyrohet të sigurojë leje në pajtim me nenin 28 të këtij ligji.

(3) Grumbullimin dhe transportin, magazinimin, trajtimin, riciklimin dhe mënyrë tjetër të përpunimit, dhe mënjanimit të mbetjeve nga përpunimi i pajisjes së hedhur, vepruesi kolektiv nuk mund t'i zbatojë në mënyrë të pavarur dhe detyrohet t'ua ngarkojë vetëm personave juridikë dhe fizikë të cilët posedojnë leje përkatëse për veprim me hedhurina në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina dhe/ose Ligjin për mjedis jetësor.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij nenit vepruesi kolektiv në shoqërim me personat fizikë dhe juridikë nga paragrafi (3) i këtij nenit mund të marrë pjesë në aktivitete lidhur me pajisjen e hedhur që ka të bëjë veçanërisht me grumbullimin ndaras të saj dhe magazinimin e përkohshëm, klasifikimin sipas kategorive, përkatësisht llojeve të pajisjes para dorëzimit për trajtim dhe veprim të mëtejmë me pajisjen e hedhur në kushte të përcaktuara me Ligjin për menaxhim me hedhurina.

(5) Prodhuesi nga paragrafi (1) i këtij nenit detyrohet që vepruesit kolektiv me të cilin ka lidhur marrëveshje për realizimin e detyrimeve nga nenit 21 i këtij ligji, t'i paguajë çmim përkatës për shërbimin lidhur me zbatimin e detyrimeve për veprim me pajisjen e hedhur në pajtim me këtë ligj, në përpjesët im me sasinë e pajisjes që prodhuesi e lëshon për herë të parë në treg në Republikën e Maqedonisë.

## Neni 28

### Vepruesi kolektiv

(1) Vepruesi kolektiv mund të veprojë me pajisje të hedhur për llogari të prodhuesve nëse ka siguarar marrëveshje përmarrjen e detyrimeve për veprim me pajisje të hedhur me prodhues të cilët së bashku lëshojnë në treg në Republikën e Maqedonisë së paku 20% por jo më shumë se 51% të sasisë të pajisjes nga e cila krijohet pajisja e hedhur nga ekonomitetë familjare nga viti gjithëpërfshirës në vitin paraprak dhe/ose së paku 5% të sasisë së pajisjes nga e cila krijohet pajisja e hedhur e cila nuk është e hedhur nga ekonomitetë familjare nga sasia gjithëpërfshirëse vjetore në vitin paraprak dhe të posedojë leje nga paragrafi (2) i këtij nenit.

(2) Vepruesi kolektiv detyrohet të sigurojë leje për veprim me pajisje të hedhur nga organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në bazë të kërkesës me shkrim e cila përmban sidomos:

- 1) emrin/titullin dhe selinë e personit juridik;
- 2) statutin e vepruesit kolektiv;
- 3) periudhën kohore përmarrjen e cila kërkohet leja;
- 4) kategorinë e pajisjes së hedhur përmarrjen e cila siguron veprim në pajtim me nenin 21 të këtij ligji dhe
- 5) listën me titull, adresë, veprimtari, vërtetim përmarrjen e regjistrimit nga nenit 13 paragrafi (4) i këtij ligji, numrin e subjektit afarist dhe numrin tatimor të prodhuesve në emër dhe llogari të cilat do të veprojë me pajisje të hedhur;

(3) Me kërkesën nga paragrafi (2) i këtij nenit, vepruesi kolektiv detyrohet të dorëzojë:

- 1) dëshmi se, në momentin e parashtrimit të kërkesës, ka lidhur marrëveshje përmarrjen e detyrimeve për veprim me pajisje të hedhur nga personat fizikë dhe juridikë të cilët janë të regjistruar në pajtim me nenin 13 të këtij ligji dhe të cilët së bashku lëshojnë në treg ose importojnë në Republikën e Maqedonisë së paku 5%, përkatësisht 3% të sasisë të pajisjes në pajtim me kategoritë e pajisjes përmarrjen e cila kërkohet leje në vitin paraprak dhe mënyrën në të cilën planifikon që në afat prej një viti nga dita e marrjes së lejes, ta plotësojë kushtin nga paragrafi (1) i këtij nenit;
- 2) dëshmi se ka lidhur marrëveshje së paku me një grumbullues të autorizuar nga nenit 19 paragrafi (3) i këtij ligji;
- 3) dëshmi se ka lidhur së paku një marrëveshje me person juridik ose fizik përmarrjen e parashtrimit të hedhurinave dhe/ose përmarrjen e magazinimit të

përkohshëm, marrëveshje me person juridik për trajtim, dhe/ose marrëveshje me person juridik për përpunimin ose riciklimin e pajisjes së hedhur i cili posedon leje përkatëse në pajtim me Ligjin për menaxhim me hedhurina dhe/ose Ligjit për mjedis jetësor ose leje ekuivalente me to kur personi juridik për trajtim, përpunim ose riciklim është jashtë vendit dhe 4) program për veprim me pajisje të hedhur nga neni 31 i këtij ligji.

(4) Përveç dokumenteve nga paragrafët (2) dhe (3) i këtij neni, e varësishët nga kategoria dhe lloji i pajisjes së hedhur, organi profesional sipas nevojës mund të kërkojë që kërkuesi të dorëzojë edhe të dhëna tjera plotësuese në pajtim me këtë dhe/ose tjetër ligj.

(5) Nëse vjen deri te ndryshimi i të dhënave të dorëzuara me kërkësën nga paragrafët (2) dhe (3) i këtij neni, vepruesi kolektiv detyrohet ta njoftojë organin profesional më së voni në afat prej dy muajsh nga momenti i ndodhjes së ndryshimit.

(6) Leja nga paragradi (2) i këtij neni lëshohet për periudhë prej pesë vitesh.

(7) Lejen nga paragradi (2) i këtij neni e lëshon organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në bazë të propozimit të organit profesional.

(8) Leja nga paragradi (2) i këtij neni mund të lëshohet për veprim me më tepër kategori të pajisjes ose vetëm për kategori të caktuara në pajtim me kërkësën e dorëzuar.

(9) Vepruesi kolektiv prodhuesve me të cilët ka lidhur marrëveshje përmarrjen e detyrimit për veprim me pajisje të hedhur detyrohet t'u lëshojet vërtetim përmarrëveshje të lidhur e cila është bazë përlirim nga pagimi i kompensimit nga neni 41 parografi (2) i këtij ligji.

(10) Formën dhe përbajtjen e vërtetimit nga paragradi (9) i këtij neni e përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor

(11) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk e lëshon lejen për veprim me pajisje të hedhur, përkatësisht nuk miraton aktvendim përfuzim të kërkësës përlëshimin e lejes nga paragradi (2) i këtij neni në afat prej 60 ditësh, parashtuesi i kërkësës ka të drejtë në afat prej tri ditësh pune nga kalimi i këtij afati të parashtrojë kërkësë në sekretarinë e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, përlëshimin e lejes, përkatësisht të miratojë aktvendim me të cilin refuzohet lëshimi i lejes nga paragradi (2) i këtij neni. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së organit të administratës shtetërore kompetent përfuzim me punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(12) Formën dhe përbajtjen e formularit të kërkësës nga paragradi (10) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent përfuzim me punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(13) Me kërkësën nga paragradi (10) i këtij neni parashtuesi i kërkësës paraqet edhe kopje të kërkësës nga paragradi (2) i këtij neni përlëshimin e lejes.

(14) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent përfuzim me punët nga sfera e mjedisit jetësor, detyrohet që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtimit të kërkësës nga paragradi (10) i këtij neni në sekretari, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa përlëshimin e lejes nga paragradi (2) i këtij ligji pranohet ose refuzohet.

(15) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent përfuzim me punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk e miraton aktvendimin në afatin nga paragradi (13) i këtij neni, parashtuesi i

kérkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(16) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga pranimi i njoftimit nga paragrafi (14) i këtij neni të kryejë mbikëqyrje inspektuese në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe të vërtetojë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kérkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(17) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e obligon ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët në sferën e mjedisit jetësor, që në afat prej dhjetë ditëve të vendosë për kérkesën e parashtruar, përkatësisht ta miratojë ose refuzojë kérkesën, dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kérkesën e parashtruar.

(18) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (16) i këtij neni, inspektori do të parashtrojë kérkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune, në të cilin ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor do të vendosë për kérkesën e parashtruar me çka në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kérkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kérkesës për masat e ndërmarrë

(19) Nëse ministri nuk vendos as në afatin plotësues nga paragrafi (17) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në këtë afat e informon parashtruesin e kérkesës për masat e ndërmarrë.

(20) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (14) i këtij neni parashtruesi i kérkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të parashtrojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kérkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(21) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit, ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (19) i këtij neni, dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kérkesës në pajtim me paragrafët (14) dhe (15) të këtij neni, dhe/ose nuk paraqet kallëzim në pajtim me nenet (17) dhe (18) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrojë kérkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punën nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura në pajtim me Ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kérkesës për masat e ndërmarrë.

(22) Nëse inspektori nuk vepron as në afatin plotësues nga paragrafi (20) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kérkesës për masat e ndërmarrë.

(23) Në rastin nga paragrafi (21) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit

Shtetëror administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta realizojë menjëherë mbikëqyrjen.

(24) Në rastin nga paragrafi (22) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve e informon parashtuesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(25) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrin (20) të këtij neni, parashtuesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditësh pune.

(26) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (17) i këtij neni, parashtuesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(27) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(28) Nëse Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e refuzon kërkesën për dhënen e lejes nga paragafi (2) i këtij neni, parashtuesi ka të drejtë të parashtrojë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënieve së Punës në Shkallë të Dytë.

## Neni 29

### **Veprimi i pavarur me pajisje të hedhur**

(1) Prodhuesit detyrimet nga neni 21 i këtij ligji mund t'i realizojnë në mënyrë të pavarur nëse për këtë kanë siguruar leje për veprim me pajisje të hedhur dhe janë të regjistruar në regjistr te organi profesional.

(2) Leja nga paragafi (1) i këtij neni, jepet në pajtim me dispozitat nga nenet 28 dhe 31 të këtij ligji.

(3) Në bazë të lejes së marrë, organi profesional jep vërtetim që prodhuesi është i regjistruar në evidencën e prodhuesve si subjekt i cili në mënyrë të pavarur siguron veprim me pajisje të hedhur për pajisje që për herë të parë e lëshon në tregun e Republikës së Maqedonisë.

(4) Vepruesi i pavarur detyrohet t'i zbatojë të gjitha detyrimet që në pajtim me këtë ligj janë përcaktuar si detyrim për veprues kolektiv dhe për prodhues.

(5) Vepruesi i pavarur detyrohet që të dorëzojë raporte në pajtim me nenin 38 të këtij ligji.

(6) Formën dhe përbajtjen e vërtetimit nga paragafi (3) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(7) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk e lëshon lejen për veprim me pajisje të hedhur, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës për lëshimin e lejes nga paragafi (2) i këtij ligji në afat prej 60 ditësh, parashtuesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune të parashtrojë kërkesë në sekretarinë e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, për lëshim të lejes, përkatësisht miratim të aktvendimit me të cilin refuzohet lëshimi i lejes nga paragafi (2) i këtij neni. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së organit të administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(8) Formën dhe përbajtjen e formularit nga paragafi (7) i këtij neni e

përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(9) Me kërkesën nga paragrafi (7) i këtij nenit, parashtruesi i kërkesës parashtron kopje të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij nenit për lëshimin e lejes.

(10) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor detyrohet që në afat prej pesë ditësh pune nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (7) i këtij nenit në sekretari, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për lëshim të lejes nga paragrafi (2) i këtij nenit, pranohet ose refuzohet.

(11) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk e miraton aktvendimin në afatin nga paragrafi (10) i këtij nenit, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Administrativ Shtetëror në afat prej pesë ditësh pune.

(12) Inspektorati Administrativ Shtetëror detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (11) i këtij nenit të kryejë mbikëqyrje inspektuese në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe të konstatojë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(13) Inspektori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor që në afat prej dhjetë ditësh pune të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta miratojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(14) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (13) i këtij nenit, inspektori do të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurë kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilin ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor do të vendosë për kërkesën e parashtruar, me çka në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditësh pune e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(15) Nëse ministri nuk vendos as në afatin plotësues nga paragrafi (14) i këtij nenit, Inspektori në afat prej tri ditësh pune do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në këtë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë.

(16) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (11) i këtij nenit, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditësh pune ka të drejtë të parashtrojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(17) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ obligohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (16) i këtij nenit dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit të parashtruesit të kërkesës nga paragrafët (11) dhe (12) të

këtij neni dhe/ose nuk paraqet kallëzim në përputhje me paragrafët (14) dhe (15) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në përputhje me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së realizuar ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(18) Nëse inspektori nuk vepron as në afatin plotësues nga paragafi (17) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditësh pune e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(19) Në rastin nga paragafi (18) i këtij neni drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(20) Në rastin nga paragafi (19) i këtij neni drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej një dite pune e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(21) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragafin (17) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditësh pune.

(22) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragafi (14) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(23) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(24) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor e refuzon kërkesën për lëshim të lejes nga paragafi (2) i këtij neni, parashtruesi ka të drejtë të parashtrojë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

## Neni 30

### **Heqja e lejes dhe shlyerja nga regjistri**

(1) Organi profesional do të fillojë procedurë për heqjen e lejes nga neni 28 parografi (2) i këtij ligji dhe/ose të lejes nga neni 29 parografi (2) të këtij ligji, vepruesit kolektiv, përkatësisht vepruesit të pavarur nëse me raport nga mbikëqyrja e kryer konstatohet se:

- nuk siguron veprim me pajisje të hedhura në pajtim me këtë ose ligj tjetër,
- nuk dorëzon raport vjetor në pajtim me nenin 38 të këtij ligji dhe
- nuk i plotëson qëllimet në pajtim me nenin 26 dhe/ose nenin 35 të këtij ligji.

(2) Organi profesional do të fillojë procedurë për heqjen e lejes nëse me mbikëqyrje inspektuese të kryer nga inspektori shtetëror i mjedisit jetësor dëshmohet se vepruesi kolektiv ose vepruesi i pavarur grumbullimin, trajtimin, përpunimin dhe mënjanimin e pajisjes së hedhur e kryen në kundërshtim me këtë ligj dhe rregullat për menaxhim me hedhurina.

(3) Organi profesional do të fillojë procedurë për shlyerjen e prodhuesit nga regjistri i prodhuesve nga neni 13 parografi (3) i këtij ligji, nëse me raport nga mbikëqyrja e kryer konstatohet se prodhuesi i cili nuk ka

siguruar veprim me pajisje të hedhur, nuk e ka paguar kompensimin nga nenin 41 paragrafi (2) i këtij ligji për pajisjen që e ka lëshuar në treg gjatë një viti.

(4) Organi profesional do të fillojë procedurën për shlyerjen e prodhuesit nga regjistri i prodhuesve nga nenin 13 paragrafi (3) i këtij ligji, nëse me raport nga mbikëqyrja e kryer konstatohet se prodhuesi i cili është regjistruar si prodhues i vogël i ka tejkaluar sasitë e pajisjes që e ka lëshuar në treg gjatë një viti të përcaktuar me nenin 24 paragrafi (1) i këtij ligji.

## Neni 31

### Programi për veprim me pajisje të hedhur

(1) Vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur detyrohen të përpilojnë programin për veprim me pajisje të hedhur.

(2) Programi për veprim me pajisje të hedhur nga paragrafi (1) i këtij nenin (në tekstin e mëtejmë: programi) duhet të përbajë:

1) plan për marrje dhe grumbullim veç e veç të pajisjes së hedhur që i përmban të dhënat si vijon:

- kategoritë, përkatesisht llojet e pajisjes së hedhur për të cilat sigurohet marrje, grumbullim veç e veç, transport dhe veprim i mëtejmë me pajisjen e hedhur (në tekstin e mëtejmë: sistemi për veprim me pajisje të hedhur),
- mënyrën e realizimit të qëllimeve për grumbullim nga nenin 26 dhe qëllimet përpunim nga nenin 35 i këtij ligji,
- mënyrën dhe vëllimin e marrjes dhe grumbullimin veç e veç të pajisjes së hedhur nga tregtarët dhe nga shfrytëzuesit e fundit,
- mënyrën dhe vëllimin e marrjes së pajisjes së hedhur nga grumbulluesit e autorizuar dhe qendrat për grumbullim,
- pasqyrën dhe numrin e vendeve për marrje dhe vendeve për grumbullim të pajisjes së hedhur që janë përfshirë në sistemin për veprim me pajisje të hedhur, emrin dhe adresat e personave juridikë ose fizikë që udhëheqin me ato vende, duke përfshirë edhe marrëveshjet e lidhura për marrje, transport dhe grumbullim veç e veç të pajisjes së hedhur, si dhe pasqyrën që ato vende janë vendosur dhe sistemuar në pajtim me nenin 32 paragrafi (3) i këtij ligji,
- llojet dhe kapacitetet të mjetave, pajisjes dhe lokalit për marrje dhe/ose grumbullim dhe magazinim të përkohshëm, ndarjen në kategori të pajisjes së hedhur para dorëzimit të saj për trajtim dhe përpunim dhe

- sasinë e paraparë të përgjithshme vjetore të pajisjes të cilën për herë të parë në Republikën e Maqedonisë do ta lëshojnë prodhuesit në emër dhe për llogari të të cilëve vepruesi kolektiv i ndërmerr obligimet për veprim me pajisje të hedhur;

2) plan për veprim të mëtejmë me pajisje të hedhur që i përmban të dhënat si vijon:

- llojin dhe kapacitetin e instalimeve për trajtim, përpunim ose mënjanim të mbetjeve nga përpunimi i pajisjes së hedhur, duke e përfshirë rishfrytëzimin dhe riciklimin e pajisjes së hedhur, pjesëve, materialeve dhe substancave si dhe emrin dhe adresat e personave juridikë me të cilat vepruesi kolektiv ka lidhur marrëveshje dhe

- dëshmi se në instalimet për trajtim, përpunim, duke përfshirë rishfrytëzimin dhe riciklimin pajisjes së hedhur, pjesëve, materialeve dhe substancave të rrezikshme, shfrytëzohen teknika më të mira të arritshme të cilat rregullisht përsosen dhe zhvillohen dhe sigurojnë mbrojtje të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit jetësor dhe

3) plan me masat dhe mënyrën e paraparë për informim dhe tërheqje të publikut dhe shfrytëzuesve të fundit për pjesëmarrje në grumbullimin e pajisjes së hedhur, si dhe informim në pajtim me nenet 11 dhe 36 të këtij ligji dhe dëshmi se funksionimi i sistemit për veprim me pajisje të hedhur është financiarisht i qëndrueshëm, plan financiar për zhvillim dhe dëshmi për investimet fillestare në sistem.

(3) Nga programi doemos duhet të shihet se magazinimi, duke përfshirë

edhe magazinimin e përkohshëm dhe trajtimin e pajisjes së hedhur, rishfrytëzimin dhe riciklimin e pjesëve, materialeve dhe substancave janë në pajtim me kërkesat nga nenet 20 paragrafët (1), (3), (6) dhe (7) dhe 34 të këtij ligji.

(4) Vepruesi kolektiv detyrohet që në program të sigurojë masa për zbatim të sistemit për veprim me pajisjen e hedhur në pajtim me nenin 32 të këtij ligji dhe ta përpunojë atë në bashkëpunim me prodhuesit pajisja e të cilëve është përfshirë në sistem, si dhe në bashkëpunim me prodhuesit të kujdeset që programi të mbahet dhe të jetë operativ.

(5) Programi miratohet në periudhë prej pesë vjetësh.

## Neni 32

### Sistemi për veprim me pajisje të hedhur

(1) Gjatë vendosjes së sistemit për veprim me pajisje të hedhur, si dhe gjatë përpilimit të programit nga neni 31 i këtij ligji, vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur detyrohen të sigurojnë:

- 1) për shfrytëzuesit e fundit dhënie falas të pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare te tregtarët ku blejnë pajisje të re në vendin e krijimit, vendin e shitjes ose vend tjetër për marrjen e pajisjes së hedhur;
- 2) marrje falas të pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare që tregtarët e marrin në vendin e krijimit, në vendet e shitjes ose vende tjera për marrjen e pajisjes së hedhur;
- 3) marrje të pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare nga grumbullues të autorizuar dhe nga qendrat për grumbullim si fraksione të ndara të grumbulluara të hedhurinave komunale;
- 4) dorëzim të pajisjes së hedhur të grumbulluar nga pikat 2 dhe 3 të këtij parografi, në vende të grumbullimit dhe instalime për trajtim dhe përpunim, si dhe plotësim të kushteve nga neni 20 i këtij ligji dhe
- 5) informim të publikut për mënyrën e marrjes dhe dorëzimit të pajisjes së hedhur.

(2) Kur vepruesi kolektiv ose vepruesi i pavarur në sistemin e tyre për veprim me pajisje të hedhur kujdesen për pajisjen e hedhur që nuk është pajisje nga ekonomitë familjare në pajtim me nenin 18 parografi (1) të këtij ligji, si dhe për marrjen e pajisjes së hedhur nga poseduesit e nenit 33 të këtij ligji, detyrohen të sigurojnë masa për grumbullim veç e veç të pajisjes së hedhur dhe veprim të mëtejmë me pajisje të hedhur.

(3) Gjatë përcaktimit të afërsisë dhe qasjes në lokacionet e vendeve për marrje të pajisjes së hedhur sigurohet që ato të jenë në vendin e shitjes ose më së shumti 5 km linjë ajrore larg nga vendi i shitjes.

## Neni 33

### Obligimi për përfshirje në sistemin për veprim me pajisje të hedhur

(1) Poseduesi e ka për detyrë që të përfshihet në sistemin për veprim me pajisje të hedhur me zbatimin e masave dhe aktiviteteve që janë përfshirë në programin nga neni 31 i këtij ligji, që lidhen me:

- 1) sigurimin e hapësirës dhe enëve adekuate për grumbullimin e pajisjeve të hedhura dhe
- 2) vendosjen e njoftimeve ku janë përfshirë informatat nga neni 11 parografi (5) i këtij ligji dhe informatat nga neni 36 parografi (1) i këtij ligji, si veprime tjera që kanë të bëjnë me poseduesin të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Poseduesi e ka për detyrë që pajisjen e hedhur të grumbulluar t'ia dorëzojë prodhuesit ose personit juridik ose fizikë që ka leje për veprim me hedhurina në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina.

(3) Vepruesi kolektiv nuk mund ta pamundësojë përfshirjen në sistemin për veprim me pajisje të hedhura dhe me këtë zbatimin e programit nga nen 31 i këtij ligji, prodhuesit i cili kryen import të pajisjes në Republikën e Maqedonisë, as të kërkojë nga prodhuesi plotësim të kushteve tjera që mund të paraqesin bariera tregtare ose prishje të konkurrencës së tregut, nëse prodhuesi i plotëson kushtet që vlejnë edhe për prodhuesit vendorë që janë të përfshirë në sistemin e njëjtë.

## Neni 34

### Trajtimi i pajisjes së hedhur

(1) Vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur sigurojnë që pajisja e hedhur e grumbulluar që krijohet në territorin e Republikës së Maqedonisë, përveç asaj, që është e dedikuar plotësisht për rishfrytëzim si aparat i plotë, para përpunimit, riciklimit ose mënjanimit, është dorëzuar në instalimin për trajtim.

(2) Instalimet për trajtim nga paragrafi (1) i këtij nenii doemos duhet të kenë leje adekuate në pajtim me këtë ligj, rregullat për menaxhim me hedhurina ose rregullat për ambientin jetësor.

(3) Gjatë zgjedhjes së instalimit për trajtim, duhet t'i jepet përparësi instalimit që është i përfshirë në sisteme të certifikuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

(4) Në instalimin për trajtim të pajisjes së hedhur bëhet trajtim i pajisjes së hedhur me zbatimin e teknikave më të mira të arritshme.

(5) Gjatë trajtimit të pajisjes së hedhur kryet trajtim i veçantë i materialeve dhe pjesëve të pajisjes së hedhur, si dhe i pajisjes së hedhur që dedikohet për rishfrytëzim, e në rast kur pajisja e hedhur është aparat i plotë doemos duhet të ndahen lëngjet dhe gazrat duke përfshirë edhe materiale tjera, pjesë, substanca dhe preparate.

(6) Për materialet dhe pjesët përbërëse të pajisjes së hedhur të fituara pas trajtimit, doemos duhet të sigurohet rishfrytëzim, riciklim ose mënyrë tjetër e përpunimit ose mënjanim i rregullt me kapacitet dhe dinamikë që e pengon grumbullimin e pjesëve përbërëse dhe materialeve në instalimin për trajtim.

(7) Kërkesat minimale për trajtim të veçantë të pajisjes së hedhur, materialeve dhe pjesëve të pajisjes së hedhur nga paragrafi (5) i këtij ligji, si dhe kushtet minimale teknike për magazinim dhe trajtim të pajisjes së hedhur që duhet t'i plotësojë instalimi për trajtim të pajisjes së hedhur i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## Neni 35

### Përpunimi i pajisjes së hedhur

(1) Vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur sigurojnë që rishfrytëzimi i aparatave të tëra si pajisje të kenë përparësi në raport me përpunimin, përpunimi i pajisjes së hedhur të marrë të ketë përparësi në raport me mënjanimin, ndërsa gjatë përpunimit të pajisjes së hedhur rishfrytëzimi i pjesëve përbërëse të pajisjes së hedhur dhe riciklimi i materialeve të kenë përparësi në raport me mënjerat tjera të përpunimit.

(2) Vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur sigurojnë në shpenzim të vet përpunim dhe mënjanim të mbetjeve nga përpunimi në pajtim me kërkesat nga paragrafi (1) i këtij nenii për pajisjen e hedhur të trajtuar në instalimin për trajtim.

(3) Përpunim dhe mënjanim të pajisjes së hedhur mund të kryejnë vetëm personat që kanë leje adekuate në pajtim me rregullat për menaxhim me

hedhurina dhe/ose rregullat për ambientin jetësor.

(4) Vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur sigurojnë në shpenzim të vet, deri më 31 dhjetor 2020, gjatë përpunimit të pajisjes së hedhur, të arrihen qëllimet si vijojnë:

1) për pajisje të hedhur që bën pjesë në kategoritë e pajisjes nga neni 4 parografi (1) pikat 1 dhe 10 të këtij ligji, së paku:

a) shkallë të përpunimit prej 80% nga pesha mesatare për pajisje dhe

b) shkallë të rishfrytëzimit dhe riciklimit të pjesëve, materialeve dhe të substancave prej 75% nga pesha mesatare për pajisje;

2) për pajisje të hedhur që bën pjesë në kategoritë e pajisjes nga neni 4 parografi (1) pikat 3 dhe 4 të këtij ligji, së paku:

a) shkallë të përpunimit prej 75% nga pesha mesatare për pajisje dhe

b) shkallë të rishfrytëzimit dhe riciklimit të pjesëve, materialeve dhe të substancave prej 65 % nga pesha mesatare për pajisje;

3) për pajisje të hedhur që bën pjesë në kategoritë e pajisjes nga neni 4 parografi (1) pikat 2, 5, 6, 7 dhe 9 të këtij ligji, së paku:

a) shkallë të përpunimit prej 70 % nga pesha mesatare për pajisje dhe

b) shkallë të rishfrytëzimit dhe riciklimit të pjesëve, materialeve dhe të substancave prej 50 % nga pesha mesatare për pajisje;

4) për pajisje të hedhura, poçe elektrike me zbrasje të gaztë nga Lista e llojeve të prodhimeve nga neni 41 parografi (4) i këtij ligji, së paku 80% rishfrytëzim dhe riciklim të pjesëve, materialeve dhe substancave nga pesha e prodhimit.

(5) Për përllogaritjen e shkallëve të pjesëmarrjeve nga parografi (4) i këtij neni, operatori i instalimit për trajtim, përkatësisht përpunim ka për detyrë të mbajë evidencë për pajisjen e hedhur, pjesëve, materialeve dhe substancave të asaj pajisjeje që hyn dhe del nga instalimi për trajtim dhe ose hyn në instalim për përpunim ose riciklim. Pjesë përbërëse e asaj evidence janë edhe formularët për transport të pajisjes dhe formularët për transport të dërgesave të hedhurinës në pajtim me dispozitat për menaxhim me hedhurina dhe deklaratë për pranimin dhe dorëzimin e pajisjes së hedhur.

(6) Gjatë përllogaritjes së shkallëve të pjesëmarrjeve nga pajisja nga parografi (4) i këtij neni deri më 31 dhjetor 2020 nuk merret parasysh sasia e pajisjes së hedhur e cila është rishfrytëzuar si aparat i plotë, ndërsa merret parasysh gjatë përllogaritjes së sasisë së pajisjes së hedhur që është eksportuar për përpunim, rishfrytëzim ose riciklim.

(7) Evidenca nga parografi (5) i këtij neni mbahet në mënyrë të përcaktuar në nenin 39 paragrafët (2) dhe (4) të këtij ligji.

(8) Nëse pajisja e hedhur është eksportuar në pajtim me Ligjin përratifikimin e Konventës së Bazelit për kontroll të lëvizjes jashtkuftare të hedhurinave të rrezikshme dhe prolongimit të tij, sasia e asaj pajisjeje merret parasysh te përllogaritja e pjesëmarrjes nga parografi (4) i këtij neni vetëm nëse te eksportuesi ekziston dëshmi se përpunimi, rishfrytëzimi dhe/ose riciklimi janë kryer në mënyrë që nuk është e dëmshme për ambientin jetësor dhe ekuivalente me mënyrën e përcaktuar me këtë ligj, rregullat përmjetë të mjedisit jetësor dhe menaxhim me hedhurina.

(9) Për arritjen e qëllimeve nga parografi (4) i këtij neni, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton qëllimet vjetore për përpunim për vitin e ardhshëm në pajtim me programin nga neni 43 i këtij ligji, më së voni deri më 15 dhjetor në vitin paraprak.

## Neni 36

### Obligime për informim

(1) Vepruesi kolektiv, përkatësisht vepruesi i pavarur detyrohet që në sistemin e tij për veprim me pajisje të hedhur të sigurojë vendosje të

Plakateve ose materialeve tjera informative me të cilat do ta informojë publikun dhe shfrytëzuesit e fundit për punët nga nenin 11 i këtij ligji.

(2) Kryetari i komunës, kryetari i komunave në qytetin e Shkupit dhe kryetari i qytetit të Shkupit në bashkëpunim me grumbulluesin e autorizuar detyrohet që në vende përkatëse ta informojë publikun për adresat e qendrave grumbulluese që ekzistojnë në zonën e asaj komune, në qytetin e Shkupit ose në komunat e qytetit të Shkupit, që janë përfshirë në sistemin për veprim me pajisje të hedhur, përkatësisht ku kryhet grumbullimi i pajisjes së hedhur.

## Neni 37

### Mbajtja e evidencës

(1) Organi profesional mban evidencë të vepruesve kolektivë që kanë marrë leje në pajtim me nenin 28 të këtij ligji, si dhe të prodhuesve që kanë lidhur marrëveshje përmarrje të obligimeve për veprim me pajisje të hedhur me vepruesin kolektiv.

(2) Evidencën nga parografi (1) i këtij nenit organi profesional detyrohet ta azhurnojë rregullisht dhe ta publikojë në ueb faqen e vet.

(3) Organi profesional në evidencën nga parografi (1) i këtij nenit i fut edhe vepruesit e pavarur nga nenin 29 i këtij ligji.

(4) Formën dhe përbajtjen e formularit dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga parografi (1) i këtij nenit, e përcakton ministri i cili udhëheq me organin kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

## Neni 38

### Obligime për dorëzimin e raporteve

(1) Vepruesi kolektiv detyrohet që, më së voni seri më 31 mars të vitit rrjedhës, në organin kompetent të dorëzojë raport vjetor për veprim me pajisje të hedhur nga prodhuesit në emër dhe për llogari të të cilëve është përgjegjës për veprim të rregullt me pajisjen e hedhur për vitin paraprak, në formular i cili përmban të dhëna sidomos për:

- 1) sasinë sipas kategorive dhe llojit të pajisjes që është lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë;
- 2) sasinë sipas kategorive dhe llojit të pajisjes së hedhur që është grumbulluar;
- 3) sasinë sipas kategorive dhe llojit të pajisjes që është dorëzuar për trajtim;
- 4) sasinë e pajisjes së hedhur sipas kategorive që është përpunuar, rishfrytëzuar, dhe/ose ricikluar ose përpunuar në mënyrë tjetër;
- 5) sasinë e pajisjes së hedhur të mbledhur veçmas sipas kategorisë që është eksportuar dhe
- 6) sasinë dhe përqindjet e realizimit të qëllimeve nga nenet 26 dhe 35 të këtij ligji.

(2) Vepruesi i pavarur detyrohet që raportin vjetor nga parografi (1) i këtij nenit ta dorëzojë për pajisje të hedhur të cilën vetë për herë të parë e ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë.

(3) Njoftimi bëhet në mënyrë të përcaktuar në nenin 39 të këtij ligji.

(4) Raporti vjetor nga parografi (1) i këtij nenit para dorëzimit në organin profesional detyrimisht vërtetohet nga person tjetër i pavarur juridik i regjistruar për kryerjen e veprimitarisë përkatëse.

(5) Formën dhe përbajtjen e formularit nga parografi (1) i këtij nenit e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(6) Organi kompetent detyrohet që ta miratojë reportin vjetor nga paragafi (1) i këtij neni në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit.

(7) Prodhesi detyrohet që të mbajë evidencë për sasitë sipas kategorisë dhe llojit të pajisjes që e lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë gjatë një viti kalendarik në formë me shkrim dhe elektronike në formular të veçantë dhe deri më 31 mars të vitit rrjedhës për vitin paraprak ta njoftojë:

- 1) organin profesional kur nuk siguron veprim me pajisje të hedhur për çka e paguan kompensimin nga neni 41 paragafi (2) i këtij ligji;
- 2) vepruesin kolektiv kur veprimin me pajisje të hedhur ia ka besuar atij;
- 3) organin profesional kur është i regjistruar si veprues i pavarur ose
- 4) organin profesional kur është prodhes i vogël.

(8) Përllogaritja e sasisë së pajisjes që është lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë kryhet nëpërmjet mbledhjes së njëherdhme të peshës së pajisjes, duke mos e llogaritur pajisjen që është eksportuar nga Republika e Maqedonisë.

(9) Formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragafi (7) i këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(10) Raportin e parë vjetor nga paragafi (1) i këtij neni dhe njoftimin e parë nga paragafi (7) i këtij neni e dorëzojnë prodhesit nëse nuk kanë lidhur marrëveshje me vepruesin kolektiv.

## Neni 39

### Dorëzimi i raporteve

(1) Personi juridik dhe fizik i cili për vepruesin kolektiv ose vepruesin e pavarur kryen grumbullim dhe magazinim të pajisjes së hedhur detyrohet që të përpilojë dhe t'u dorëzojë raporte vepruesit kolektiv ose vepruesit të pavarur për sasitë e pajisjes së hedhur të grumbulluar të dorëzuar për veprim të mëtejshmë, në formular të veçantë.

(2) Personi juridik dhe fizik i cili për vepruesin kolektiv ose vepruesin e pavarur kryen trajtim të pajisjes së hedhur detyrohet që të mbajë evidencë për sasinë e pajisjes së hedhur e cila merret dhe e cila hyn dhe/ose del nga instalimi për trajtim, si dhe të përpilojë dhe t'u dorëzojë raporte vepruesit kolektiv ose vepruesit të pavarur për sasitë e pajisjes së hedhur që është trajtuar, në formular të veçantë.

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularëve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, si dhe mënyrën e dorëzimit të tyre i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Personi juridik dhe fizik që kryen përpunimin e pajisjes së hedhur detyrohet të mbajë evidencë dhe të përpilojë dhe dorëzojë raport për përpunim të pajisjes së hedhur që arrihet në çdo vit kalendarik në pajtim me nenin 35 të këtij ligji.

(5) Raporti nga paragafi (4) i këtij neni i dorëzohet vepruesit kolektiv ose të pavarur në pajtim me paragrafin (8) të këtij neni.

(6) Pjesë përbërëse e raporteve nga paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij neni janë deklarata për pranimin dhe dorezimin e pajisjes së hedhur, formularët për transport të hedhurinës dhe formularët për qarkullim tejkufitar në pajtim me rregullat për menaxhim me hedhurina.

(7) Formën dhe përmbajtjen e formularëve nga paragafi (4) i këtij neni, si dhe mënyrën e dorëzimit të tyre i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(8) Afati i dorëzimit të raporteve të këtij nenit rregullohet me marrëveshjen e lidhur ndërmjet vepruesit kolektiv ose vepruesit të pavarur dhe personit juridik dhe fizik për kryerjen e punëve nga paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij neni në mënyrë e cila do të mundësojë respektimin e detyrimeve për dorëzim të raporteve vepruesit kolektiv ose vepruesit të pavarur të përcaktuar me këtë ligj.

## Neni 40

### Baza e të dhënave dhe sistemi informativ

(1) Organi profesional vendos dhe mban bazë të të dhënave për pajisjen që lëshohet në qarkullim në Republikën e Maqedonisë dhe për veprimin me pajisjen e hedhur.

(2) Baza nga paragrafi (1) i këtij neni mbahet në bazë të të dhënave nga raportet në pajtim me nenet 38 dhe 39 të këtij ligji dhe veçanërisht i përmban të dhënat në vijim:

- 1) sasitë dhe kategoritë e pajisjes që lëshohet në treg në Republikën e Maqedonisë;
- 2) sasinë e pajisjes së grumbulluar sipas kategorive dhe
- 3) pasqyrën e përgjithshme të veprimit me pajisje të hedhur (rishfrytëzim, riciklim dhe mënyrë tjetër të përpunimit).

(3) Në bazë të të dhënave nga paragrafi (2) i këtij neni, organi profesional më së voni deri më 30 maj në vitin rrjedhës publikon raport në të cilin përshkruhet gjendja me menaxhimin me pajisjen që lëshohet në treg në Republikën e Maqedonisë.

(4) Me reportin nga paragrafi (3) i këtij neni organi profesional publikon edhe të dhëna për realizimin e programit nga neni 43 i këtij ligji, si dhe të dhëna për sistemet ekzistuese për veprim me pajisje të hedhur.

(5) Të dhënat e grumbulluara në bazë të paragrafit (2) të këtij neni përpunoher dhe validizohen nga Ministria e Mjedisit Jetësor-Qendra Informativë Maqedonase për Mjedisin Jetësor në Sistemin Informativ për pajisje të hedhura, që është pjesë përbërëse e Sistemit informativ të mjedisit jetësor.

(6) Të dhënat e përpunuara dhe të validizuara nga paragrafi (5) i këtij neni dorëzohen në Komisionin Evropian dhe trupat tjera dhe organet e Unionit Evropian dhe janë të arritshme për publikun.

## Neni 41

### Instrumentet ekonomike

(1) Prodhesi i cili lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë pajisje, si dhe prodhesi i cili si shfrytëzues i fundit importon në Republikën e Maqedonisë pajisje, detyrohet të paguajë kompensim për menaxhim me pajisje të hedhura (në tekstin e mëtejshmë: kompensim).

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni është për:

1) aparat të madh shtëpiak	50 den/kg
2) aparat të vogël shtëpiak	80 den/kg
3) pajisje për teknologji informatike dhe telekomunikacion	60 den/kg
3.1) monitor	70 den/kg
4) pajisje të konsumit të gjerë dhe elektronikë argëtuese	60 den/kg
4.1) aparate televizive	90 den/kg
5) Pajisje për ndriçim	80 den/kg
5.1) poçe fluoreshente, kompakte dhe poçe tjera	120 den/kg

6) vegla elektrike dhe elektronike	100 den/kg
7) lodra elektrike dhe elektronike dhe pajisje për argëtim dhe sport	100 den/kg
8) aparate mjekësore	100 den/kg
9) instrumente për përcjellje dhe kontroll	100 den/kg
10) automate	50 den/kg.

(3) Kompensimi përllogaritet në bazë të peshës neto të pajisjes, për njësi pjesë të pajisjes e shprehur në kilogramë për çka mbahet evidencë dhe përpilohet përllogaritje mujore në formular të veçantë.

(4) Listën e llojeve të prodhimeve të cilat bëjnë pjesë në kategoritë e pajisjes nga neni 4 paragrafi (1) i këtij ligji, e për të cilat paguhet kompensim nga paragrafi (2) i këtij ligji, e publikon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Obligimi për llogaritjen e kompensimit për prodhuesin krijohet në momentin kur për herë të parë e lëshon pajisjen në tregun e Republikës së Maqedonisë.

(6) Obligimi për llogaritjen e kompensimit për prodhuesin i cili si shfrytëzues i fundit importon në Republikën e Maqedonisë pajisje me shfrytëzimin e së cilës krijon pajisje të hedhur, krijohet në momentin kur ka filluar ta shfrytëzojë atë.

(7) Prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit importon pajisje detyrohet që ta paguajë kompensimin nga paragrafi (2) i këtij neni në llogari pagesore adekuatë në kuadër të llogarisë së thesarit në ditën e 15 të muajit rrjedhës për të gjitha kompensimet e llogaritura nga muaji paraprak.

(8) Kompensimi nuk paguhet nëse pajisja eksportohet.

(9) Në rastin nga paragrafi (8) i këtij neni, prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit importon pajisje, detyrohet që të sigurojë deklaratë doganore eksportuese si dëshmi që sasia e pajisjes, për të cilën nuk është llogaritur kompensim nga paragrafi (2) i këtij neni, është eksportuar nga Republika e Maqedonisë.

(10) Në rast të eksportit të pajisjes për të cilën është paguar kompensim i caktuar nga paragrafi (2) i këtij neni, prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit importon pajisje, kanë të drejtë të kthimit të kompensimit të paguar për sasinë e eksportuar të pajisjes.

(11) Kthimi i kompensimit të paguar kryhet në bazë të kërkesës së dorëzuar për kthim të kompensimit të paguar në afat prej 30 ditësh pas krijimit të shkaqeve për kthim në formular të veçantë.

(12) Kthimi i kompensimit të paguar kryhet me aktvendim të lëshuar nga organi profesional, pas kontrollit paraprak të dokumentacionit të dorëzuar dhe përcaktimit të plotësimit të kushteve për kthim të kompensimit të paguar në pajtim me këtë ligj.

(13) Kundër aktvendimit nga paragrafi (12) i këtij pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(14) Mjetet nga kompensimi nga paragrafi (2) i këtij neni janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe paguhën në llogari pagesore adekuatë të veçantë, në kuadër të llogarisë së thesarit.

(15) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e financave i përcakton formën dhe përbajtjen e formularit nga

paragradi (3) i këtij neni, mënyrën dhe dokumentacionin e nevojshëm përkthimin e kompensimit në rastet nga paragradi (10) i këtij neni, si dhe formën dhe përbajtjen e formularit nga paragradi (11) i këtij neni.

### **Neni 41-a**

#### **Obligimi për mënyrën e përllogaritjes, pagesës si dhe përbajtjen e evidencës për kompensimin e përllogaritur dhe të paguar**

(1) Prodhuesi i cili lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë pajisje dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit importon pajisje në Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejshmë: "detyrësi") është i obliguar që kompensimin nga neni 41 paragradi (2) të këtij ligji, ta përllogaritë dhe ta paguajë me kohë dhe në mënyrë të drejtë si dhe të mbajë, mirmbjajë dhe ruajë një evidencë të rregullt dhe të saktë për kompensimin e përllogaritur dhe të paguar.

(2) Në bazë të evidencës nga paragradi (1) i këtij neni, detyrësi përpilon dhe në çdo tre muaj dorëzon te organi profesional përllogaritje për kompensimin e paguar në formular të veçantë.

(3) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent përkryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton mënyrën e mbajtjes, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së evidencës nga paragradi (1) i këtij neni si dhe formën dhe përbajtjen e formularit nga paragradi (2) i këtij neni.

### **Neni 41-b**

#### **Mbikëqyrja e kompensimit të përllogaritur dhe të paguar**

(1) Mbikëqyrje mbi kompensimin e përllogaritur dhe të paguar, lirimin nga pagesa e kompensimit, si dhe për respektimin e afateve për pagesën e kompensimeve i kryen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor përmes inspektorëve shtetërorë të mjedisit jetësor.

(2) Për mbikëqyrjen e realizuar nga paragradi (1) i këtij neni, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor miraton aktvendim.

(3) Kundër aktvendimit nga paragradi (2) i këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë që të parashtrojë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(4) Në rast kur me aktvendim nga paragradi (2) i këtij neni, që është përfundimtar në procedurë administrative, është përcaktuar kthimi i kompensimit të paguar, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor është i obliguar që aktvendimin ta dorëzojë te Ministria e Financave për zbatimin e tij.

(5) Në rast kur me aktvendim nga paragradi (2) i këtij neni, që është përfundimtar në procedurë administrative, përcaktohet se detyrësi duhet të paguajë kompensim, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor është i obliguar që aktvendimin ta dorëzojë te detyrësi i cili është i obliguar që ta paguajë kompensimin në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(6) Në rastet nga paragradi (5) i këtij neni, kur detyrësi nuk e ka paguar kompensimin ashtu siç është përcaktuar në aktvendimin nga paragradi (2) i këtij neni, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor është i obliguar që aktvendimin ta dorëzojë te organi kompetent për zbatim të detyrueshëm, për zbatimin e tij.

## Neni 42

### **Lirimi nga pagesa e kompensimit**

(1) Nga pagesa e kompensimit nga nenii 41 paragrafi (2) i këtij ligji lirohen:

1) prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit importon pajisje, për të cilën ka lidhur marrëveshje për marrje të obligimeve për veprim me pajisje të hedhur, me veprues kolektiv i cili ka të siguruar leje në pajtim me nenin 28 të këtij ligji.

2) prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit importon pajisje, ka të siguruar vërtetim që prodhuesi është i regjistruar në evidencën e prodhuesve si subjekt i cili në mënyrë të pavarur siguron veprim me pajisje të hedhur dhe i cili ka të siguruar leje në pajtim me nenin 29 paragrafi (1) të këtij ligji.

3) prodhuesi dhe prodhuesi i cili si shfrytëzues i fundit importon pajisje, e cila nuk është pajisje nga ekonomitë familjare, për të cilën ka siguruar si veprues i pavarur ose nëpërmjet vepruesit kolektiv, plotësim të qëllimeve nga nenii 35 i këtij ligji, nga sasia vjetore që e ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë dhe

4) prodhuesi i cili është caktuar si prodhues i vogël në pajtim me nenin 24 të këtij ligji.

(2) Prodhesi dhe prodhesi i cili si shfrytëzues i fundit importon pajisje nga paragrafi (1) pika 1 e këtij nenii janë të liruar nga pagesa e kompensimit nga nenii 41 paragrafi (2) i këtij ligji nëse posedon vërtetim nga nenin 28 paragrafi (9) i këtij ligji.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij nenii, kompensimi nga nenii 41 paragrafi (2) i këtij ligji paguhet në shumë të dyfishtë, nëse:

1) vepruesi kolektiv ose vepruesi i pavarur nuk dorëzon raport në pajtim me nenin 38 të këtij ligji;

2) organi profesional nuk e miraton raportin në pajtim me nenin 38 paragrafi (5) të këtij ligji, për mosplotësimin e qëllimeve të përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji dhe/ose nuk është siguruar plotësim i qëllimeve të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji. Në këtë rast kompensimi paguhet në shumë të dyfishtë vetëm për dallimin ndërmjet qëllimeve të përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji dhe qëllimeve të arritura në rast kur janë arritur qëllimet nga nenii 26 i këtij ligji, përkatësisht në shumë të trefishtë për dallimin në qëllimet e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji dhe qëllimet e arritura në rast kur nuk janë arritur qëllimet nga nenii 26 i këtij ligji, në pajtim me raportin vjetor dhe/ose konstatimin e organit profesional dhe

3) prodhuesi ka dorëzuar raport vjetor të pasaktë në pajtim me nenin 38 të këtij ligji, lidhur me sasinë e pajisjes që e ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë ose e ka importuar si shfrytëzues i fundit.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij nenii organi profesional miraton aktvendim.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë te ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(6) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij nenii, kompensimi i dyfishtë, përkatësisht kompensimi i trefishtë llogaritet sipas lartësisë mesatare të kompensimit të përcaktuar në nenin 41 paragrafi (2) të këtij ligji, në përpjesët im me pjesën dhe sasinë e pajisjes që është lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë në vitin paraprak.

## Neni 43

### **Programi për menaxhim me pajisje të hedhur**

(1) Për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në nenet 26 dhe 35 të këtij ligji me propozim të organit profesional, ministri i cili udhëheq me organin e

administratës shtetërore kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetesor miraton program për menaxhim me pajisje të hedhura (në tekstin e mëtejmë: program).

(2) Programi miratohet për periudhë prej së paku prej pesë vjetësh dhe veçanërisht përbman:

- përshkrimin dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese në menaxhimin me pajisjen,
- sistemin e subjekteve që veprojnë me pajisje të hedhur,
- sasinë dhe llojin e pajisjes që lëshohet në treg në Republikën e Maqedonisë, si dhe parashikimet e ardhshme dhe trendin e zhvillimit në periudhën e ardhshme pesëvjeçare,
- masa për nxitjen e grumbullimit dhe përpunimit të pajisjes së hedhur,
- masa për nxitjen e hulumtimit dhe përmirësimet në aspekt të karakteristikave të përgjithshme ekologjike gjatë ciklit të tij të përgjithshëm jetësor,
- masa për zhvillimin dhe marketingun e pajisjes së dizajnuar në mënyrë e cila i plotëson kushtet nga nenet 8 dhe/ose 9 të këtij ligji,
- masa me qëllim të ndihmës së zhvillimit të teknologjive të reja për trajtim, riciklim dhe përpunim dhe nxitje të hulumtimit të metodave ekologjike dhe rentabile për trajtim dhe riciklim të të gjitha kategorive të pajisjes së hedhur,
- masa për mbështetjen e kapaciteteve për trajtim dhe përpunim me qëllim të vendosjes së programit të certifikuar për menaxhim ekologjik që kanë të bëjnë me sisteme për menaxhim me ambientin jetësor dhe për revizion (EMAS),
- masa për parandalimin e krijimit të pajisjes së hedhur,
- masa për nxitjen e shkallës së grumbullimit të pajisjes së hedhur dhe rishfrytëzimit të saj,
- masa për përmirësimin e gjendjes në tregun e trajtimit, përpunimit, rishfrytëzimit ose riciklimit të pajisjes së hedhur,
- masa ekonomike,
- masa për edukim dhe realizim të fushatës për ngritjen e vetëdijes publike për veprim me pajisjen e hedhur,
- pasqyrë e rregullativës ligjore për menaxhim me pajisje dhe pajisje të hedhur dhe masa për përmirësimin e saj,
- drejtime për zhvillimin e ardhshëm të menaxhimit me pajisje të hedhur dhe
- çështje tjera që janë me rëndësi për menaxhimin me pajisje dhe pajisje të hedhur.

(3) Programi përpilohet me pjesëmarrjen e personave juridikë dhe fizikë që veprojnë me pajisje të hedhur, organizatave joqeveritare dhe enteve dhe institucioneve tjera publike dhe shkencore.

## Neni 44

### **Shfrytëzimi i kompensimit dhe programi për financim**

(1) Mjetet e grumbulluara nga kompensimi nga neni 41 paragrafi (2) i këtij ligji shfrytëzohen për zbatimin e masave dhe aktiviteteve që janë përcaktuar me programin nga neni 43 i këtij ligji.

(2) Financimi dhe realizimi i masave dhe aktiviteteve nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet në bazë të programit vjetor për financim që organi kompetent e përpilon në bazë të Programit nga neni 43 i këtij ligji, në lartësi të mjeteve të përcaktuara me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin fiskal adekuat.

(3) Programin vjetor për financim e miraton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor. Programi vjetor për financim mund të miratohet në mënyrë të pavarur ose si pjesë e programit tjetër për financim që e miraton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Ndarja e mjeteve të programit nga paragrafi (3) i ketij nenii kryhet nëpërmjet konkursit publik që e publikon dhe zbaton organi profesional.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, një pjesë e mjeteve të programit nga paragrafi (3) i këtij neni, mund t'i ndajë Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, nëse janë të dedikuara për plotësimin e detyrimeve që janë përcaktuar me marrëveshjet vullnetare nga neni 46 i këtij ligji.

## Neni 45

### Konkursi publik

(1) Konkursi publik nga neni 44 paragrafi (4) i këtij ligji zbatohet nga komisioni i formuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet prej më së shumti pesë anëtarëve nga të cilët:

- një përfaqësues nga organi profesional,
- një përfaqësues nga vepruesi kolektiv nga neni 28 i këtij ligji,
- një përfaqësues nga vepruesi i pavarur nga neni 29 i këtij ligji nëse është i regjistruar si i tillë,
- një përfaqësues nga shoqata e tregtarëve që kryejnë shitje të pajisjes dhe
- një përfaqësues nga personi juridik ose fizik që ka leje për grumbullim, trajtim dhe/ose përpunim të pajisjes së hedhur.

(3) Nese në evidencën nga neni 37 i këtij ligji nuk është evidentuar vepruesi i pavarur me pajisje të hedhur, atëherë me propozim të organit profesional për anëtar të komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni emërohet përfaqësues nga personi juridik ose fizik që ka leje për grumbullim, trajtim dhe/ose përpunim të pajisjes së hedhur.

(4) Konkursi publik nga neni 44 paragrafi (4) i këtij ligji shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe së paku në dy gazeta ditore që dalin në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

(5) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni detyrohet të miratojë vendim për shpërndarjen e mjeteve në afat prej 30 ditësh nga dita e kalimit të afatit nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Rezultatet nga konkursi botohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(7) Konkursi publik nga neni 44 paragrafi (4) i këtij ligji mund të zbatohet bashkë me konkurs tjetër për ndarje të mjeteve për financim për zbatimin e të cilave është kompetent organi profesional.

## Neni 46

### Marrëveshja vullnetare

(1) Organizatat të cilat përfaqësojnë interesa të caktuara të sektorëve ekonomikë nga sfera e pajisjes ose grupit të operatorëve ekonomikë mund t'i qasen lidhjes së marrëveshjes vullnetare me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet së cilës do t'i rregullojnë të drejtat dhe obligimet e ndërsjella për informimin e shfrytëzuesve të fundit nga neni 11 i këtij ligji dhe informimin e operatorëve nga neni 12 i këtij ligji për nevojën për veprim të drejtë me pajisjen e hedhur dhe arritjen e shkallës më të lartë për grumbullim dhe përpunim dhe për vendosje të sistemeve të certifikuara për menaxhim me ambientin jetësor.

(2) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni detyrimisht i rregullon

çështjet si vijojnë:

- afatin e vlefshmërisë,
- qëllimet dhe afatin e arritjes së tyre,
- mënyrën e përcjelljes së realizimit të qëllimeve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshje,
- obligimet dhe të drejtat e operatorëve ekonomike dhe të organeve kompetente të administratës shtetërore,
- kushtet dhe mënyrat e përcjelljes së plotësimit të qëllimeve të përcaktuara në marrëveshje,
- masat, mënyrën e marrjes së masave dhe penalet që mund të zbatohen në rast të mosplotësimit të obligimeve të përcaktuara në marrëveshje dhe
- kushtet dhe mënyrat e ndërprerjes së obligimeve dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve.

(3) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni botohet në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(4) Marrëveshja nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe mënyra dhe rezultatet nga zbatimi i saj janë të arritshme për publikun.

## V. MBIKËQYRJA

### Neni 47

#### Organe mbikëqyrëse

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryen organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, kryen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor.

(3) Mbikëqyrje mbi raportet e përcaktuara në pajtim me nenet 38 dhe 39 të këtij ligji kryen organi profesional.

(4) Për punët në kompetencë të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit të përcaktuara me këtë ligj, mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin dhe implementimin e dispozitave të këtij ligji kryejnë inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave, inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave në qytetin e Shkupit dhe inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejmë: inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor).

(5) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimit dhe implementimin e këtij ligji në pjesën e shënimit të pajisjes dhe informimit të shfrytëzuesve të fundit kryen Inspektorati Shtetëror i Tregut.

(6) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji në pjesën e veprimit të paligjshëm me pajisjen e hedhur nga qytetarët dhe lënies ose dorëzimit të saj si hedhurinë komunale të pakasifikuar, kryejnë inspektorët komunalë të komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejmë: inspektor komunal) dhe inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor.

### Neni 48

#### Procedura e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese

(1) Mbikëqyrja inspektuese mbi personat juridikë dhe fizikë që menaxhojnë me pajisje të hedhur kryhet si mbikëqyrje e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese, si dhe pas marrjes së kallëzimit dhe/ose njoftimit nga organet tjera shtetërore, organizatat, institucionet, personat juridikë dhe fizikë, si dhe nga mjetet e informimit publik.

(2) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Jetësor, përkatësish kryetari i komunës, kryetari i komunave në qytetin e Shkupit dhe kryetari i qytetit të Shkupit, detyrohen që çdo vit të miratojnë program për punën e inspektoratit, përkatësish inspektorëve.

(3) Programin nga paragrafi (2) i këtij nenit, kryetari i komunës, kryetari i komunave në qytetin e Shkupit dhe kryetari i qytetit të Shkupit e dorëzon te organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, inspektori komunal dhe inspektori shtetëror i tregut, gjatë marrjes së aktiviteteve për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji, mund të kërkojnë bashkëpunim nga përfaqësues të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme.

## Neni 49

### **Veprimi për kallëzim nga personi fizik ose juridik**

(1) Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, inspektori komunal dhe inspektori shtetëror i tregut detyrohen që në afat prej shtatë ditësh të veprojnë për iniciativë ose kallëzim për ngritje të procedurës inspektuese.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij nenit inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, inspektori komunal dhe inspektori shtetëror i tregut detyrohen që ta njoftojnë parashtuesin e iniciativës ose kallëzimit për ngritje të procedurës inspektuese në afat prej shtatë ditësh nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

## Neni 50

### **Raporte**

Inspektori shtetëror për mjedis jetësor, inspektori i autorizuar për mjedis jetësor, inspektori komunal përkatësish inspektori shtetëror i tregut i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese është i detyruar të mbajë evidencë për mbikëqyrjet dhe kontrolllet e kryera te personat juridikë dhe fizikë për të cilët përpilon raport tremujor dhe të njëjtin e publikon në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në ueb faqen e komunës përkatësish Qytetit të Shkupit në ueb faqen e Inspektoratit Shtetëror të Tregut në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor, përkatësish Ligjin për inspektoratin shtetëror të tregut.

## Neni 51

### **Të drejta dhe obligime për mënjanimin e parregullsive**

(1) Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, inspektori komunal dhe inspektori shtetëror i tregut në pajtim me këtë ligj për mënjanimin e parregullsive të konstatuara, kanë të drejtë dhe obligim që subjektit të mbikëqyrjes:

- 1) t'i sugjerojnë për parregullsitë e konstatuara dhe të caktojnë afat për mënjanimin e tyre;
- 2) t'i urdhërojnë që të marrë masa dhe aktivitete përkatëse në afatin të cilin do ta përcaktojnë;
- 3) përkohësish t'ia ndalojnë ushtrimin e veprimtarisë, profesionit ose detyrës;
- 4) t'i parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse dhe
- 5) t'i parashtrojë kallëzim penal ose të ngrejë procedurë tjetër përkatëse.

(2) Për mënjanimin e parregullsive të përcaktuara, inspektori shtetëror i

mjedisit jetësor, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor dhe inspektori shtetëror i tregut mund të kryejnë edhe autorizime dhe përgjegjësi tjera në pajtim me ligj.

## Neni 52

### Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i vet inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, ka të drejtë që:

- 1) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse pajisja ka prani të metaleve të rënda në kundërshtim me nenin 9 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 2) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesit i informojnë operatorët e instalimeve për rishfrytëzim, instalimeve për trajtim dhe riciklim të pajisjes së hedhur në mënyrë në pajtim me nenin 12 të këtij ligji;
- 3) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse personat juridikë ose fizikë të cilët lëshojnë pajisje në treg në Republikën e Maqedonisë janë të regjistruar dhe posedojnë vërtetim për përfshirje në regjistrin në pajtim me nenin 13 të këtij ligji (neni 13 paragrafët (1) dhe (4));
- 4) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll nëse prodhuesit veprojnë në pajtim me nenin 13 paragrafi (6) të këtij ligji;
- 5) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll nëse prodhuesit veprojnë në pajtim me nenin 13 paragrafi (7) të këtij ligji;
- 6) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse personat juridikë dhe fizikë veprojnë me pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) të këtij ligji
- 7) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse personat juridikë dhe fizikë veprojnë me pajisjen e hedhur e cila nuk është pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare në pajtim me nenin 15 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 8) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse personat juridikë dhe fizikë si shfrytëzues të fundit pajisjen e hedhur e grumbullojnë dhe ruajnë ndaras dhe veprojnë me të në pajtim me nenin 15 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji;
- 9) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse personat juridikë dhe fizikë si shfrytëzues të fundit me pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare veprojnë në pajtim me nenin 15 paragrafi (5) të këtij ligji;
- 10) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse tregtar vepron në pajtim me nenin 16 të këtij ligji;
- 11) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse tregtar ka siguruar vende për marrjen e pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;
- 12) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse tregtar vepron në pajtim me nenin 17 paragrafi (4) i këtij ligji;
- 13) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesi e merr pajisjen e hedhur nga shfrytëzuesit e fundit në pajtim me nenin 18 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 14) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse shfrytëzuesi i fundit i cili posedon pajisje të hedhur siguron veprim me pajisjen e hedhur në pajtim me nenin 18 paragrafi (3) të këtij ligji;
- 15) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesi në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet veprueshit kolektiv siguron marrje të rregullt të pajisjes së hedhur nga grumbulluesi i autorizuar në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 16) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse personat fizikë dhe juridikë të cilët kryejnë grumbullimin, transportimin, magazinimin dhe trajtimin e pajisjes së hedhur veprojnë në pajtim me nenin 20 të këtij ligji;
- 17) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesi në

mënyrë të pavarur ose nëpërmjet vepruesit kolektiv i plotëson detyrimet të cilat dalin nga nen 21 i këtij ligji;

18) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesi, poseduesi dhe/ose tregtar i cili për kryerjen e veprimtarisë ose aktivitetit të tij, vetë importon pajisje dhe për këtë nuk ka ndërmjetësues paraprak ose furnizues në Republikën e Maqedonisë, vepron në pajtim me nenin 23 paragafi (1) të këtij ligji;

19) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse tregtar i cili për kryerjen e shitjes së pajisjes vepron në pajtim me nenin 23 paragafi (2) të këtij ligji;

20) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesi i plotëson detyrimet të cilat dalin nga nen 24 i këtij ligji;

21) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatoje nëse janë plotësuar kushtet për lirim nga nen 24 i këtij ligji;

22) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesi në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet vepruesit kolektiv vepron me pajisjen e hedhur në pajtim me nenin 27 paragafi (1) të këtij ligji;

23) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatoje nëse vepruesi kolektiv punët nga nen 27 paragafi (3) ua ka ngarkuar personave të tretë të cilët kanë leje për veprim me hedhurina;

24) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse vepruesi kolektiv posedon leje në pajtim me nenin 28 paragafi (2) të këtij ligji;

25) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatoje nëse vepruesi kolektiv i ka plotësuar detyrimet të cilat dalin në pajtim me nenin 28 paragafi (5) të këtij ligji;

26) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse vepruesi kolektiv jep vërtetim në pajtim me nenin 28 paragafi (9) të këtij ligji;

27) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesi i cili në mënyrë të pavarur vepron me pajisjen e hedhur, posedon leje në pajtim me nenin 29 të këtij ligji;

28) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatoje nëse vepruesi kolektiv dëshiron që përpiluar program për veprim me pajisjen e hedhur në pajtim me nenin 31 paragafi (1) të këtij ligji;

29) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatoje nëse vepruesi kolektiv në program siguron masa për zbatimin e sistemit për veprim me pajisje të hedhur në pajtim me nenin 32 të këtij ligji;

30) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse vepruesi kolektiv i zbaton masat nga nenin 32 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

31) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse qasja e lokacioneve në vende përmarrjen dhe grumbullimin e pajisjes së hedhur, i plotësojnë kushtet nga nen 32 paragafi (3) i këtij ligji;

32) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse poseduesi i cili posedon pajisje ka vendosur njoftime në të cilat janë përfshire informata për veprimin me pajisjen e hedhur dhe nëse i zbatojnë detyrimet e tyre për veprim me pajisje të hedhur në pajtim me nenin 33 paragafi (1) të këtij ligji;

33) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse poseduesi me pajisje të hedhur vepron në pajtim me nenin 33 paragafi (2) të këtij ligji;

34) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të përcaktojë nëse vepruesi kolektiv vepron në kundërshtim me nenin 33 paragafi (3) të këtij ligji;

35) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse ka siguruar masa me të cilat pajisja e hedhur e grumbulluar është dorëzuar për trajtim në kushte në pajtim me nenin 34 paragafi (1) i këtij ligji;

36) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatoje nëse trajtimi i pajisjes së hedhur dhe magazinimi i pajisjes së hedhur bëhet në kushte dhe në mënyrë në pajtim me nenin 34 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji;

37) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatoje nëse dokumentet dhe të dhënat me të cilat konstatohet se janë plotësuar qëllimet përpunim nga nen 35 i këtij ligji janë autentike;

38) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse mbahet evidencë në pajtim me nenin 35 paragafi (5) të këtij ligji;

39) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse janë plotësuar detyrimet për informim në pajtim me nenin 36 të këtij ligji;

40) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatoje nëse dokumentet

dhe të dhënat me të cilat vërtetohet se janë plotësuar qëllimet për grumbullim nga neni 26 i këtij ligji janë autentike;

41) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse mbahet evidencë dhe dorëzohen raporte në pajtim me nenet 38 dhe 39 të këtij ligji;

42) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse janë plotësuar detyrimet të cilat dalin nga marrëveshjet vullnetare në pajtim me nenen 46 të këtij ligji dhe

43) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojë nëse janë plotësuar detyrimet dhe kushtet për veprim me pajisje të hedhur që janë përcaktuar me këtë ligj.

(2) Me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Jetësor në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese mund të marrë pjesë edhe nëpunësi shtetëror i punësuar në organin profesional.

(3) Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor detyrohet të kryejë mbikëqyrje inspektuese kur këtë e kërkon organi profesional.

## Neni 53

### Miratimi i aktvendimeve të inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese të personave juridikë dhe fizikë, inspektori i mjedisit jetësor, me aktvendim:

1) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej së paku 90 ditësh nëse pajisja e hedhur ka substanca të rrezikshme në kundërshtim me atë që është e përcaktuar në nenen 9 të këtij ligji dhe për këtë do ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror të Tregut.

2) do ta detyrojë që t'i plotësojë detyrimet nga neni 12 i këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara;

3) do t'i detyrojë të regjistrohen në pajtim me nenen 13 të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e përcaktuara;

4) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet në pajtim me nenen 13 paragrafi (6) të këtij ligji;

5) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet në pajtim me nenen 13 paragrafi (7) të këtij ligji;

6) do t'i detyrojë të veprojnë në pajtim me nenen 15 paragrafi (1) të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë dhe pasojat;

7) do t'i detyrojë të veprojnë në pajtim me nenen 15 paragrafi (2) të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë dhe pasojat;

8) do t'i detyrojë që pajisjen e hedhur ta grumbullojnë dhe ruajnë ndaras dhe të veprojnë me të në pajtim me nenen 15 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji, si dhe do të caktojnë afat plotësues i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara dhe pasojat;

9) do t'i detyrojë të veprojnë në pajtim me nenen 15 paragrafi (5) të këtij ligji dhe do të caktojnë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara dhe pasojat;

10) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet nga neni 16 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojë parregullsitë e konstatuara dhe pasojat.

11) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet për marrjen dhe dorëzimin e pajisjes së hedhur nga ekonomitë familjare në pajtim me nenen 17 të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojë parregullsitë e konstatuara;

12) do t'i detyrojë t'i zbatojnë detyrimet nga neni 18 paragrafi (1) i këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojë parregullsitë e konstatuara;

13) do t'i detyrojë t'i zbatojnë detyrimet nga neni 18 paragrafi (3) të këtij

- ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara dhe pasojat;
- 14) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet nga nenin 19 paragrafi (1) të këtij ligji, dhe do të caktojë afat plotësues i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara dhe pasojat;
- 15) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet nga nenin 20 të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara dhe pasojat;
- 16) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej së paku 30 ditësh nëse nuk janë plotësuar kushtet për veprim me pajisje të hedhur dhe nuk plotësohen detyrimet për veprim të parapara në pajtim me nenin 20 të këtij ligji dhe do t'i detyrojë që në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara dhe pasojat;
- 17) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet nga nenin 21 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara dhe pasojat;
- 18) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet nga nenin 23 i këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara;
- 19) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet nga nenin 24 i këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e përcaktuara;
- 20) do t'i detyrojë të ndërmarrin masa për veprim me pajisje të hedhur nëse nuk i plotësojnë detyrimet nga nenin 26 i këtij ligji;
- 21) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditësh nëse nuk kanë lidhur marrëveshje për marrjen e detyrimeve për veprim me pajisje të hedhur me veprues kolektiv ose vetë nuk vepron me pajisjen e hedhur si veprues i pavarur në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 22) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 30 ditësh nëse punët për veprim me pajisje të hedhur nuk ua ka ngarkuar personave të tretë në pajtim me nenin 27 paragrafi (3) të këtij ligji;
- 23) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditësh nëse vepruesi kolektiv nuk posedon leje nga nenin 28 paragrafi (2) i këtij ligji;
- 24) do ta detyrojë të ndërmarrë masa për plotësimin e detyrimeve nga nenin 28 paragrafi (5) të këtij ligji;
- 25) do ta detyrojë të ndërmarrë masa për plotësimin e detyrimeve nga nenin 28 paragrafi (9) të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 që t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara;
- 26) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej së paku 90 ditësh nëse vepruesi individual nuk posedon leje dhe nuk vepron në pajtim me nenin 29 të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e përcaktuara;
- 27) do të propozojë fillimin e procedurës për marrjen e lejes nga nenin 28 paragrafi (2) dhe vërtetimit nga nenin 13 paragrafi (4) të këtij ligji dhe do të propozojë fillimin e procedurës për shlyerje nga regjistri nga nenin 13 paragrafi (3) të këtij ligji nëse përcakton se nuk janë plotësuar kërkesat në pajtim me nenin 30 të këtij ligji.
- 28) do ta detyrojë të ndërmarrë masa që të përpilojë program për veprim me pajisjen e hedhur në pajtim me nenin 31 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 29) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej së paku 30 ditësh nëse nuk ndërmerr masa dhe nuk i plotësojnë detyrimet nga nenin 31 paragrafi (4) të këtij ligji dhe do t'i detyrojë në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë t'i mënjanojnë parregullsitë e përcaktuara dhe pasojat;
- 30) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 30 ditësh nëse nuk i plotësojnë detyrimet nga nenin 32 paragrafi (1) të këtij ligji dhe do t'i detyrojë në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e përcaktuara dhe pasojat;
- 31) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 30 ditësh nëse nuk i plotësojnë detyrimet nga nenin 32 paragrafi (2) të këtij ligji dhe do t'i detyrojë në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë t'i mënjanojnë parregullsitë dhe pasojat e përcaktuara;
- 32) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90

ditësh nëse nuk i plotëson kushtet nga nenin 32 paragrafi (3) dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë t'i mënjanojnë parregullsitë e përcaktuara;

33) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet në pajtim me nenin 33 paragrafi (1) të këtij ligji;

34) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 30 ditësh nëse nuk i plotësojnë detyrimet nga nenin 33 paragrafi (1) të këtij ligji dhe do t'i detyrojë në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë t'i mënjanojnë parregullsitë;

35) do ta detyrojë të veprojë në pajtim me nenin 33 paragrafi (2) të këtij ligji, dhe do të caktojë afat prej më së shumti 30 ditësh t'i mënjanojë parregullsitë dhe pasojat e përcaktuara;

36) do ta detyrojë të veprojë në pajtim me nenin 33 paragrafi (3) të këtij ligji dhe do të caktojë afat prej më së shumti 30 ditësh t'i mënjanojë parregullsitë dhe pasojat e përcaktuara;

37) do t'i detyrojë të ndërmarrin masa që pajisja e hedhur e grumbulluar të dorëzohet në trajtim dhe në kushte në pajtim me nenin 35 paragrafi (1) të këtij ligji dhe do t'i caktoje afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë t'i mënjanojnë parregullsitë dhe pasojat;

38) do t'i detyrojë që trajtimi dhe magazinimi i pajisjes së hedhur të zhvillohet në pajtim me nenin 34 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji dhe do t'i caktojë afat i cili nuk mund të jetë me i gjatë se 6 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë dhe pasojat;

39) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditësh nëse nuk i plotësojnë detyrimet nga nenin 34 të këtij ligji dhe do t'i detyrojë në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë t'i mënjanojnë parregullsitë dhe pasojat;

40) do t'i detyrojë të ndërmarrin masa për veprim me pajisje të hedhur nëse nuk i plotësojnë detyrimet nga nenin 35 të këtij ligji;

41) do t'i detyrojë të ndërmarrin masa për plotësimin e detyrimeve nga nenin 35 paragrafi (5) të këtij ligji dhe do t'i caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë;

42) do t'i detyrojë t'i plotësojnë detyrimet për informim nga paragrafi (1) i këtij ligji dhe do t'i caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë;

43) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej më së shumti 90 ditësh nëse nuk mban evidencë dhe nuk dorëzon raporte nga nenet 38 dhe 39 të këtij ligji dhe do t'i caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 90 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë;

44) do t'i detyrojë të ndërmarrin masa për plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen vullnetare në pajtim me nenin 46 të këtij ligji dhe

45) do t'i detyrojë të ndërmarrin masa për plotësimin e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligji.

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i mjedisit jetësor konstaton se subjektet të cilët menaxhojnë me pajisjen e hedhur nuk i respektojnë ligjet dhe rregullat tjera, rregullat teknike, standardet, rekomandimet dhe aktet tjera të përgjithshme me procesverbal do t'i konstatojë parregullsitë e përcaktuara dhe në aktvendim do ta caktojë afatin në të cilin duhet të mënjanohen.

(3) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij nenii nuk veprojnë në pajtim me aktvendimin e inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor dhe nuk i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar të përcaktuar me aktvendimin, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor do t'i parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në Komisionin për Vendosje për Kundërvajtje në Sferën e Mjedisit Jetësor në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejmë: Komisioni kundërvajtës), përkatësisht në gjykatën kompetente.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij nenii pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënieve së Punës në Shkallë të Dytë.

(5) Komisioni Shtetëror për Vendimmarje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë nga paragrafi (4) i këtij nenit detyrohet që vendimin për ankesën ta miratojë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(6) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij nenit nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

(7) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij nenit, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor ka të drejtë për marrje edhe të masave tjera të përcaktuara me Ligjin për mjedis jetësor dhe Ligjin për menaxhim me hedhurina.

## Neni 54

### **Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor dhe inspektorit komunal**

Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i tij inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor dhe inspektori komunal kanë të drejtë që:

- 1) të kryejnë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojnë nëse personat juridikë ose fizikë e dorëzojnë ose lënë pajisje të hedhur si hedhurinë të paklasifikuar komunale;
- 2) të kryejnë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojnë nëse personat juridikë ose fizikë si shfrytëzues të fundit pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare e dorëzojnë në pajtim me nenin 15 paragrafi (5) të këtij ligji;
- 3) të kryejnë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojnë nëse grumbulluesi i autorizuar vepron me pajisjen e hedhur në pajtim me nenin 20 të këtij ligji;
- 4) të kryejnë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojnë nëse në qendrat e grumbullimit, pajisja e hedhur ruhet dhe veprohet me të në pajtim me nenin 20 paragrafi (6) të këtij ligji dhe
- 5) të kryejnë mbikëqyrje dhe kontroll dhe të konstatojnë nëse grumbulluesi i autorizuar jep vërtetim për pranim - dorëzimin e pajisjes së hedhur në pajtim me nenin 20 paragrafi (8) të këtij ligji.

## Neni 55

### **Miratimi i aktvendimeve të inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor dhe inspektorit komunal**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, personat juridikë ose fizikë, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor dhe inspektori komunal, me aktvendim:

- 1) do t'i detyrojë që pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare ta dorëzojnë si fraksion të ndarë të hedhurinave komunale në qendrën e grumbullimit dhe do t'u caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojnë pasojat në pajtim me nenin 14 të këtij ligji;
- 2) do t'i detyrojë që pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare ta dorëzojnë në pajtim me nenin 15 paragrafi (5) të këtij ligji, si dhe do t'u caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojnë pasojat;
- 3) do t'i detyrojë t'i përbushin detyrimet nga nenii 20 i këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë që t'i mënjanojnë parregullsitë e konstataura dhe pasojat dhe
- 4) do ta kufizojë dhe/ose ndalojë punën në afat prej së paku 30 ditësh nëse nuk janë plotësuar kushtet për veprim me pajisje të hedhur dhe nuk zbatohen detyrimet për veprim të parapara në pajtim me nenin 20 paragrafi (6) të këtij ligji dhe do t'i detyrojë që në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë t'i mënjanojnë parregullsitë e konstataura dhe pasojat.

(2) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, përkatesisht inspektori komunal konstaton se subjektet

që menaxhojnë me pajisjen e hedhur nuk u përmbahen ligjeve dhe rregullave tjera, rregullave teknike, standardeve, rekomandimeve dhe akteve tjera të përgjithshme, me procesverbal do t'i konstatojë parregullsitë e konstataura dhe në aktvendim do ta caktojë afatin në të cilin duhet të mënjanohen.

(3) Nese subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk veprojnë në pajtim me aktvendimin e inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor, përkatësisht inspektorit komunal dhe nuk i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e kriuar, të përcaktuara me aktvendimin, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektorit komunal do të parashtrojë kërkësë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para Komisionit për Kundërvajtje, përkatësisht gjykatës kompetente.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënieve së Punës në Shkallë të Dytë.

(5) Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënieve së Punës në Shkallë të Dytë nga paragrafi (4) i këtij neni detyrohet që vendimin për ankesë ta miratojë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(6) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

(7) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektorit komunal ka të drejtë të marrjes edhe të masave tjera të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për menaxhim me hedhurina.

## Neni 56

### Fushëveprimi i mbikëqyrjes së inspektorit shtetëror të tregut

(1) Në kryerjen e mbikëqyrjes nga fushëveprimi i tij, inspektori shtetëror i tregut ka të drejtë që:

- 1) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të konstatojë nëse pajisja e cila lëshohet në treg në Republikën e Maqedonisë i plotëson kushtet të cilat kanë të bëjnë me përbërjen lidhur me metalet e rënda në pajisje në pajtim me nenin 9 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 2) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të konstatojë nëse pajisja e cila lëshohet në treg në Republikën e Maqedonisë është e shënuar në pajtim me nenin 10 të këtij ligji;
- 3) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të konstatojë nëse shfrytëzuesit e fundit të pajisjes nga ekonomitë familjare informohen në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 4) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesi i informon tregtarët dhe distributorët për mënyrën e marrjes së pajisjes së hedhur nga shfrytëzuesi i fundit në pajtim me nenin 11 paragrafi (3) të këtij ligji dhe
- 5) të kryejë inspektim dhe kontroll dhe të konstatojë nëse prodhuesi dhe tregtar kanë vendosur njoftim për shfrytëzuesin e fundit në pajtim me nenin 11 paragrafi (5) të këtij ligji.

(2) Në kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni inspektori i tregut ka të drejtë të marrjes edhe të masave tjera të përcaktuara me Ligjin për Inspektoratin shtetëror të tregut, Ligjin për mbikëqyrje inspektuese, Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për menaxhim me hedhurina.

## Neni 57

## **Miratimi i aktvendimeve të inspektorit shtetëror të tregut**

- (1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i tregut, personat juridikë dhe fizikë me aktvendim:
- 1) do t'i detyrojë ta tërheqin nga tregu pajisjen e cila ka prani të metaleve të rënda në kundërshtim me dispozitat e nenit 9 të këtij ligji;
  - 2) do t'i detyrojë ta tërheqin nga tregu pajisjen e cila nuk është e shënuar në pajtim me nenin 10 të këtij ligji;
  - 3) e kufizon dhe/ose ndalon punën në afat prej më së shumti 15 ditësh nëse pajisja e cila është e lëshuar në treg nuk është e shënuar në pajtim me nenin 10 të këtij ligji dhe do t'i detyrojë që në afat prej 30 ditësh t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara;
  - 4) do ta detyrojë t'i informojnë shfrytëzuesit e fundit në mënyrë në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji;
  - 5) do t'i detyrojë të dorëzojnë njoftim për mënyrën e marrjes së pajisjes së hedhur nga shfrytëzuesi i fundit, në pajtim me nenin 11 paragrafi (3) të këtij ligji dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojnë parregullsitë e konstatuara dhe
  - 6) do t'i detyrojë të vendosin njoftim për shfrytëzuesit e fundit për mënyrën dhe për vendet për dorëzim dhe vendet për grumbullim të pajisjes së hedhur dhe do të caktojë afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë në të cilin duhet t'i mënjanojë parregullsitë e konstatuara në pajtim me nenin 11 paragrafi (5) të këtij ligji.

(2) Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk veprojnë në pajtim me aktvendimin e inspektorit shtetëror të tregut dhe nuk i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar, të përcaktuara me aktvendimin, inspektori shtetëror i tregut do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në Komisionin për Kundërvajtje, përkatësisht gjykatën kompetente.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënieve së Punës në Shkallë të Dytë.

(4) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

(5) Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënieve së Punës në Shkallë të Dytë nga paragrafi (3) i këtij neni detyrohet që vendimin për ankesën ta miratojë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

### **Neni 58**

#### **Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera në mbikëqyrjen inspektuese**

(1) Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor dhe inspektori komunal, mbikëqyrjen inspektuese në sferën e menaxhimit me pajisjen e hedhur, e kryejnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, Ligjit për menaxhim me hedhurina dhe Ligjit për mjedisin jetësor.

(2) Inspektori shtetëror i tregut mbikëqyrjen inspektuese në sferën e menaxhimit me pajisjen e hedhur e kryejnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, Ligjit për inspektoratin shtetëror të tregut, Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, Ligjit për menaxhim me hedhurina dhe Ligjit për mjedisin jetësor.

### **Neni 59**

## Procedura e edukimit

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori shtetëror i tregut konstaton se është bërë parregullsi nga nenet 10, 11, 13, 16 paragrafi (1), 17 paragrafi (1) dhe 18 paragrafi (1) të këtij ligji për herë të parë, detyrohet që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsine e bërë me sugjerim për mënjanimin e parregullsise së konstatuar në afatin e caktuar dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për zbatimin e edukimit të personit ose subjektit ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor

(3) Edukimin e organizon dhe zbaton Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, përkatësisht Inspektorati Shtetëror i Tregut në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të zbatohet për më shumë parregullsi të përcaktuara të njëjtë ose të ngashme për një ose më tepër subjekte.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin zbatohet edukimi, nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është zbatuar.

(6) Nëse personi ose subjekti për të cilin zbatohet edukimi paraqitet në terminin e caktuar dhe e kryen atë do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsine e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori shtetëror i tregut gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij nenit, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori shtetëror i tregut gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij nenit, parashton kërkësë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në Komisionin për Kundërvajtje, përkatësisht gjykatën kompetente.

(9) Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, përkatësisht Inspektorati Shtetëror i Tregut mban evidencë unike për edukimin e zbatuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

## VI. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

### **Neni 60**

#### **Sanksione kundërvajtëse për prodhuesit**

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit i cili është person juridik, nëse:

- 1) nuk siguron që në vendet e shitjes të vendoset në vend të dukshëm njoftim për shfrytëzuesin e fundit, për mënyrën dhe për vendet për marrjen e pajisjes së hedhur (neni 11 paragrafi (5));
- 2) nuk siguron të dhëna për operatorët e instalimeve për rishfrytëzim, instalimeve për trajtim dhe riciklim të pajisjes së hedhur në pajtim me nenin 12 të këtij ligji;
- 3) në rast të ndryshimit të të dhënave të dorëzuara gjatë regjistrimit, nuk

ka bërë ndryshim të regjistrimit me dorëzimin e kërkesës për ndryshimin e të dhënavë (neni 13 paragrafi (6)) dhe  
4) në rast të shuarjes së veprimtarisë, përkatësisht lëshimit të pajisjes në treg në Republikën e Maqedonisë, nuk ka dorëzuar kërkesë për shlyerje nga regjistri (neni 13 paragrafi (7)).

(2) Gjobë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik për veprimet nga paragradi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet prodhuesit i cili është person fizik për veprimet nga paragradi (1) i këtij neni.

## Neni 61

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit i cili është person juridik, nëse:

- 1) prodhon pajisje e cila nuk është në pajtim me kërkesat nga neni 8 i këtij ligji;
- 2) pajisjen të cilën e lëshon në treg nuk e shënon në pajtim me nenin 10 paragradi (1) të këtij ligji;
- 3) nuk vepron në pajtim me nenin 10 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji në rast të shënimit të pajisjes;
- 4) nuk i informon shfrytëzuesit e fundit të pajisjes në mënyrë në pajtim me nenin 11 paragradi (1) të këtij ligji;
- 5) nuk i informon shfrytëzuesit e fundit të pajisjes në pajtim me nenin 11 paragradi (3) të këtij ligji;
- 6) nuk regjistrohet si prodhues i pajisjes në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor dhe nuk posedon vërtetim përfshirje në regjistër (neni 13 paragrafët (1) dhe (4));
- 7) refuzon ta marrë falas pajisjen e hedhur e cila nuk është pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare të cilën ia ka dërguar shfrytëzuesit të fundit dhe për të nuk siguron veprim të mëtejshmë (neni 18 paragradi (1));
- 8) nuk vepron dhe nuk siguron marrje të rregullt të pajisjes së hedhur në pajtim me nenin 19 paragradi (1) të këtij ligji;
- 9) me shpenzim të vet, në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet vepruesit kolektiv nuk siguron grumbullim veç e veç, trajtim, përpunim, rishfrytëzim dhe/ose riciklim dhe mënjanim të mbetjeve nga përpunimi i pajisjes së hedhur në pajtim me nenin 21 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji;
- 10) nuk vepron në pajtim me nenin 23 paragradi (1) të këtij ligji kur për kryerjen e aktivitetit të tij, vetë importon pajisje dhe kur njëkohësisht është shfrytëzues i fundit i pajisjes (neni 23 paragradi (1));
- 11) nuk mban evidencë dhe nuk njofton për sasitë dhe llojet e pajisjes të cilën e lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë gjatë një viti kalendarik në mënyrë në pajtim me nenin 37 paragradi (7) të këtij ligji dhe
- 12) nuk vepron në pajtim me nenin 41 paragradi (1) të këtij ligji nëse lëshon në treg ose importon në Republikën e Maqedonisë pajisje.

(2) Gjobë në shumë prej 900 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragradi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 600 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit i cili është person fizik për veprimet nga paragradi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragradi (1) pikat 6), 7), 9) dhe 10) të këtij neni mund t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar nga e cila del kundërvajtja në kohëzgjatje prej së paku tri dite deri në më së shumti 30 ditë.

(5) Personit përgjegjës te personi juridik nga paragradi (2) dhe personit fizik nga paragradi (3) i këtij neni, mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës nga e cila del kryerja e

kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku tri ditë deri në më së shumti 15 ditë.

## Neni 62

- (1) Gjobë në shumë prej 6.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit i cili është person juridik, nëse:
- 1) vepron në kundërshtim me nenin 9 paragrafi (1) i këtij ligji;
  - 2) plotësimin e detyrimeve nga neni 21 i këtij ligji nuk i realizon pavarësisht ose nuk lidh marrëveshje për marrjen e detyrimeve për veprim me pajisjen e hedhur me vepruesin kolektiv (neni 27 paragrafi (1)) dhe
  - 3) nuk i plotëson detyrimet e përcaktuara në marrëveshjet vullnetare (neni 46).

(2) Gjobë në shumë prej 900 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni mund t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar nga e cila del kundërvajtje në kohëzgjatje prej së paku tri ditë deri në më së shumti 30 ditë.

(5) Personit përgjegjës te personi juridik nga paragrafi (2) dhe personit fizik nga paragrafi (3) i këtij neni, mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës nga e cila del bërja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku tri ditësh deri në më së shumti 15 ditë.

## Neni 63

### Sanksione kundërvajtëse për prodhues të vogël

(1) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë më denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit të vogël i cili është person juridik, nëse:

- 1) në rast të ndryshimit të dhënave të dorëzuara gjatë regjistrimit, nuk e ndryshon regjistrimin me dorëzimin e kërkesës për ndryshimin e të dhënave (neni 13 paragrafi (6)) dhe
- 2) nuk mban evidencë për sasitë dhe llojet e pajisjes të cilën e lëshon në treg në Republikën e Maqedonisë gjatë një viti kalendarik (neni 38 paragrafi (7));

(2) Gjobë në shumë prej 700 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit të vogël i cili është person fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 64

(1) Gjobë në shumë prej 3.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje prodhuesit të vogël i cili është person juridik, nëse:

- 1) nuk regjistrohet si prodhues i vogël i pajisjes në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor (neni 24 paragrafi (2)) dhe
- 2) ka dorëzuar të dhëna të rrejshme me qëllim që të tregohet si prodhues i vogël dhe të përjashtohet nga detyrimi si prodhues (neni 24 paragrafi

(3)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personit juridik për veprimet nga paragafi (4) i këtij neni.

(3) Gjabe në shumë prej 900 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet prodhuesit të vogël i cili është person fizik për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragafi (1) pika 1 e këtij neni mund t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrimin e veprimitarës së caktuar nga e cila del kundërvajtja në kohëzgjatje prej së paku tri ditësh deri në më së shumti 30 ditë.

(5) Personit përgjegjës te personi juridik nga paragafi (2) i këtij neni dhe personit fizik nga paragafi (3) i këtij neni, mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës nga e cila del kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku tri ditë deri në më së shumti 15 ditë.

## Neni 65

### Sanksione kundërvajtëse për tregtarët

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit i cili është person juridik, nëse:

1) nuk siguron që në vendet e shitjes të vendoset në vend të dukshëm njoftim për shfrytëzuesin e fundit, për mënyrën dhe për vendet përmarrjen e pajisjes së hedhur (neni 11 paragafi (5));

2) refuzon që ta marrë falas pajisjen e hedhur nga shfrytëzuesi i fundit gjatë shitjes së pajisjes për ekonomitë familjare nëse shfrytëzuesi i fundit dëshiron ta dorëzojë pajisjen e hedhur (neni 16 paragafi (1));

3) nuk vepron në pajtim me nenin 16 paragafi (2) të këtij ligji;

4) nuk siguron që shfrytëzuesit e fundit gjatë blerjes së pajisjes të kenë mundësi për dorëzim falas të pajisjes së hedhur në vendin e shitjes të pajisjes ose në vend tjetër përmarrje në rast kur tregtar nuk merr pajisje të hedhur drejtësuar nga shfrytëzuesi i fundit gjatë kohës së dërgimit të pajisjes (neni 17 paragafi (1));

5) nuk ia dorëzon falas pajisjen e hedhur të grumbulluar prodhuesit ose personit të autorizuar nga ai (neni 17 paragafi (4));

6) nuk vepron në pajtim me nenin 23 paragafi (1) të këtij ligji kur përkryerjen e aktivitetit të tij, vetë importon pajisje kur njëkohësisht është shfrytëzues i fundit i pajisjes dhe

7) nuk vepron në pajtim me nenin 23 paragafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 900 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 700 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet tregtarit i cili është person fizik për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

## Neni 66

### Sanksione kundërvajtëse për poseduesit

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje poseduesit i cili është person juridik, nëse:

1) nuk vepron në pajtim me nenin 23 të këtij ligji kur përkryerjen e aktivitetit të tij, vetë importon pajisje kur njëkohësisht është shfrytëzues i fundit i pajisjes;

2) vepron në kundërshtim me nenin 33 paragafi (1) të këtij ligji dhe

3) nuk ia dorëzon pajisjen e hedhur të grumbulluar prodhuesit ose personit juridik dhe fizik i cili ka leje për veprim me hedhurina (neni 33

paragrafi (2)).

(2) Gjobë në shumë prej 900 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik pér veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 700 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet tregtarit i cili është person fizik pér veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 67

### Sanksione kundërvajtëse pér shfrytëzuesin e fundit

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet pér kundërvajtje shfrytëzuesit të fundit i cili është person juridik, nëse:

- 1) pajisjen e hedhur e dorëzon ose e lë si hedhurinë komunale të paklasifikuar (neni 14);
- 2) pajisjen e hedhur nga ekonomitë familjare nuk e grumbullon dhe ruan dhe nuk ia dorëzon tregtarit ose grumbulluesit të autorizuar, si fraksion të ndarë të grumbulluar të hedhurinave komunale në qendrën e grumbullimit ose në vend pér marrje, punë të cilën e siguron prodhuesi (neni 15 paragrafi (1));
- 3) pajisjen e hedhur, e cila nuk është pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare nuk ia dorëzon prodhuesit ose personit juridik ose fizik. i cili ka leje pér veprim me hedhurina (neni 15 paragrafi (2));
- 4) pajisjen e hedhur para se ta dorëzojë, nuk e grumbullon ose ruan ndaras, ashtu që të mos përzihet me lloj tjetër të hedhurinave, të mos imtësohet ose në ndonjë mënyrë tjetër asgjësohet ose ndotet me substanca të rrezikshme ose substanca tjera, ashtu që rishfrytëzimi ose riciklimi i saj pamundësohet (neni 15 paragrafi (3));
- 5) nuk siguron që pajisja e hedhur të jetë në gjendje të tillë që ndarja e substancave dhe materialit të mund të zbatohet në pajtim me rregullat e veçanta me të cilat rregullohet veprimi me ato substanca dhe materiale, nëse pajisja e hedhur përmban substanca dhe materiale të cilat duhet të ndahen (neni 15 paragrafi (4));
- 6) pajisjen e hedhur e cila është e dëmtuar ose është pa pjesë të rëndësishme përbërëse ose është e ndotur me lloj tjetër të hedhurinave, nuk e dorëzon në qendër grumbullimi si fraksion të grumbulluar të ndarë të hedhurinave komunale (neni 15 paragrafi (5));
- 7) me pajisjen e hedhur nuk vepron në pajtim me nenin 18 paragrafi (3) të këtij ligji dhe
- 8) prodhuesi, poseduesi dhe/ose tregtar i cili cilësinë e shfrytëzuesit të fundit nuk veprojnë në pajtim me nenin 23 të këtij ligji;

(2) Gjobë në shumë prej 400 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik pér veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet shfrytëzuesit të fundit si operator ekonomik i cili është person fizik pér veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 68

### Sanksione kundërvajtëse pér persona juridikë që nuk janë operatorë ekonomikë

(1) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet pér kundërvajtje personit juridik i cili nuk është operator ekonomik, nëse:

- 1) pajisjen e hedhur e dorëzon ose e lë si hedhurinë komunale të paklasifikuar (neni 14);
- 2) pajisjen e hedhur e ruan dhe sistemon në kundërshtim me nenin 20

paragrafi (6) të këtij ligji;

3) pajisjen e hedhur para trajtimit e magazinon në kundërshtim me nenin 20 paragrafi (7) të këtij ligji;

4) me pajisjen e hedhur gjatë trajtimit vepron në kundërshtim me nenin 34 paragrafi (5) të këtij ligji;

5) me materialet dhe pjesët përbërëse të fituara gjatë trajtimit të pajisjes së hedhur vepron në kundërshtim me nenin 34 paragrafi (6) të këtij ligji;

6) nuk përpilon dhe dorëzon raporte për sasitë e pajisjes së hedhur të grumbulluara, të dorëzuar për veprim të mëtejmë në formular të veçantë (neni 39 paragrafi (1));

7) nuk mban evidencë dhe nuk përpilon dhe dorëzon raport për sasinë e pajisjes së hedhur të grumbulluar e cila është trajtuar në formular të veçantë (neni 39 paragrafi (2)) dhe

8) nuk mban evidencë dhe nuk përpilon dhe dorëzon raport për rishfrytëzim, përpunim ose riciklim të pajisjes së hedhur, që arrihet në çdo vit kalendarik (neni 39 paragrafi (4)).

(2) Gjobë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik, i cili nuk është operator ekonomik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

## **Neni 69**

### **Sanksione kundërvajtëse për persona fizikë**

(1) Gjobë në shumë prej 60 eurosh në kundërvlerë me denarë aty për aty do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik i cili nuk është operator ekonomik për veprimet, nëse:

1) dorëzon ose lë pajisje të hedhur nga ekomitë familjare si hedhurinë komunale të paklasifikuar (neni 14).

(2) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, përkatesisht inspektori komunal, gjobën nga paragrafi (1) i këtij neni, do ta shqiptojnë me dorëzimin e ftesës për pagesën e gjobës të cilën kryerësi detyrohet ta paguajë në afat prej tetë ditësh.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton formën dhe përmbytjen e ftesës për pagesë të gjobës nga paragrafi (2) i këtij neni.

## **Neni 70**

### **Sanksione kundërvajtëse për vepruesin e pavarur**

(1) Gjobë në shumë prej 4.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje vepruesit të pavarur i cili është person juridik, nëse:

1) nuk e njofton organin profesional për ndryshimin e krijuar të të dhënavë të dorëzuara me kërkesën për marrjen e lejes për veprim me pajisje të hedhur (neni 28 paragrafi (5));

2) nuk përpilon program për veprim me pajisjen e hedhur (neni 31 paragrafi (1));

3) në programin për veprim me pajisje të hedhur nuk siguron masa përzbatimin e sistemit për veprim me pajisjen e hedhur në pajtim me nenin 32 të këtij ligji (neni 31 paragrafi (4));

4) nuk i siguron kushtet e përcaktuara me nenin 32 paragrafi (1) të këtij ligji;

5) nuk i siguron kushtet e përcaktuara me nenin 32 paragrafi (2) të këtij ligji;

6) gjatë përcaktimit të afërsisë dhe qasjes në lokacionet në vende përmarrjen e pajisjes së hedhur, nuk i respektojnë dispozitat e nenit 32 paragrafi (3) të këtij ligji;

7) në sistemin e vet për veprim me pajisjen e hedhur nuk siguron vendosjen e pllakateve ose materialit tjetër informativ, me të cilat do ta

informojë publikun dhe shfrytëzuesit e fundit për punët nga neni 11 i këtij ligji (neni 36 parografi (1)) dhe

8) nuk dorëzon në kohën e caktuar raport për veprim me pajisjen e hedhur (neni 38 parografi (2));

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në vepruesin e pavarur me pajisjen e hedhur për veprimet nga parografi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur me pajisjen e hedhur i cili është person fizik për veprimet nga parografi (1) i këtij neni.

## Neni 71

(1) Gjobë në shume prej 8.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje vepruesit të pavarur i cili është person juridik, nëse:

1) nuk sigurojnë masa për marrje dhe grumbullim falas dhe veprim të mëtejjmë me pajisjen e hedhur e cila nuk është pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare në pajtim me nenen 18 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, përveç nëse ekziston marrëveshje e veçantë me shfrytëzuesin e fundit, për marrjen e pajisjes së hedhur e cila nuk është pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare;

2) kryerjen e punëve për veprim me pajisjen e hedhur ia ka ngarkuar personave të tretë të cilët nuk posedojnë leje përkatëse për veprim me hedhurina (neni 27 parografi (3));

3) nuk ka ndërmarrë masa me të cilat sigurohet që pajisja e hedhur e grumbulluar të dorëzohet në instalimin për trajtim (neni 34 parografi (1));

4) nuk ka ndërmarrë masa me të cilat sigurohet që trajtimi i pajisjes së hedhur të grumbulluar të bëhet në pajtim me nenen 34 parografi (5) të këtij ligji;

5) nuk ka ndërmarrë masa me të cilat sigurohet që me materialet dhe pjesët përbërëse të pajisjes së hedhur të fituara pas trajtimit, të veprohet në pajtim me nenen 34 parografi (6) të këtij ligji;

6) nuk ka ndërmarrë masa me të cilat sigurohet që përpunimi i pajisjes së hedhur të grumbulluar të bëhet në pajtim me nenen 35 paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij ligji;

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në vepruesin e pavarur me pajisjen e hedhur për veprimet nga parografi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 3.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur me pajisje të hedhur i cili është person fizik për veprimet nga parografi (1) i këtij neni

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga parografi (1) pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni mund t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar nga e cila del kundërvajtja në kohëzgjatje prej së paku tri ditë deri në më së shumti 30 ditë.

(5) Personit përgjegjës te personi juridik nga parografi (2) i këtij neni dhe personit fizik nga parografi (3) i këtij neni mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës nga e cila del kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku tri ditësh deri në më së shumti 15 ditë.

## Neni 72

(1) Gjobë në shumë prej 10.000 deri në 15.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje vepruesit të pavarur i cili është person juridik, nëse:

1) nuk siguron leje për veprim me pajisjen e hedhur nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor (neni 29 parografi (1));

2) dorëzon raporte me të dhëna të pasakta me qëllim që të konstatohet se janë arritur qëllimet nga nenet 26 dhe/ose 35 të këtij ligji (neni 38) dhe  
3) nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen vullnetare (neni 46).

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet vepruesit të pavarur i cili është person fizik për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

(4) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragafi (1) i këtij neni, gjykata kompetente mund t'i shqiptojë sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muaj deri në më së shumti pesë vjet.

(5) Personit përgjegjës në personin juridik nga paragafi (2) dhe personit fizik nga paragafi (3) i këtij neni, mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës nga e cila del kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku një vit deri në më së shumti pesë vjet.

## Neni 73

### Sanksione kundërvajtëse për vepruesin kolektiv

(1) Gjobë në shumë prej 6.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje vepruesit kolektiv, nëse:

- 1) kryerjen e punëve për veprim me pajisjen e hedhur nuk ia ka ngarkuar personave të tretë (neni 27 paragafi (3));
- 2) kryerjen e punëve për veprim me pajisjen e hedhur ia ka ngarkuar personave të tretë të cilët nuk posedojnë leje përkatëse për veprim me hedhurina (neni 27 paragafi (4));
- 3) nuk përpilon program për veprim me pajisjen e hedhur (neni 31 paragafi (1));
- 4) nuk i realizon detyrimet nga neni 31 paragafi (4) i këtij ligji;
- 5) nuk i siguron kushtet e përcaktuara me nenin 32 paragafi (1) të këtij ligji;
- 6) nuk i siguron kushtet e përcaktuara me nenin 32 paragafi (2) të këtij ligji;
- 7) gjatë përcaktimit të afërsisë dhe qasjes në lokacione në vende për marrjen e pajisjes së hedhur, nuk i respektojnë dispozitat e nenit 32 paragafi (3) të këtij ligji;
- 8) nuk ka ndërmarrë masa me të cilat sigurohet që pajisja e hedhur e grumbulluar të dorëzohet në instalimin për trajtim (neni 33 paragafi (1));
- 9) nuk ka ndërmarrë masa me të cilat sigurohet që trajtimi i pajisjes së hedhur të grumbulluar të bëhet në pajtim me nenin 34 paragafi (5) të këtij ligji (neni 34 paragafi (5));
- 10) nuk ka ndërmarrë masa me të cilat sigurohet që me materialet dhe pjesët përbërëse të pajisjes së hedhur të fituara pas trajtimit, të veprohet në pajtim me nenin 34 paragafi (6) të këtij ligji (neni 34 paragafi (6)) dhe
- 11) në sistemin e vet për veprim me pajisje të hedhur nuk siguron vendosje të plakateve ose materialit tjeter informativ, me të cilat do ta informojë publikun dhe shfrytëzuesit e fundit për punët nga neni 11 i këtij ligji (neni 36 paragafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në vepruesin kolektiv për veprimet nga paragafi (1) i këtij neni.

## Neni 74

(1) Gjobë në shumë prej 9.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i

shqiptohet për kundërvajtje vepruesit kolektiv, nëse:

- 1) nuk siguron masa për marrje dhe grumbullim falas dhe veprim të mëtejshmë me pajisjen e hedhur e cila nuk është pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare në pajtim me nenin 18 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, përveç nëse ekziston marrëveshje e veçantë me shfrytëzuesin e fundit, për marrjen e pajisjes së hedhur e cila nuk është pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare;
- 2) ushtron profesionin veprim me pajisje të hedhur pa marrëveshje të siguruara të mjaftueshme (neni 28 parografi (3) pika 1));
- 3) nuk e njofton organin profesional për ndryshimin e krijuar të të dhënavë të dorëzuara me kërkesën për marrjen e lejes për veprim me pajisje të hedhur (neni 28 parografi (5));
- 4) prodhuesve me të cilët ka lidhur marrëveshje për marrjen e detyrimit për veprim me pajisjen e hedhur nuk u jep vërtetim për marrëveshje të lidhur, e cila është bazë për lirim nga pagesa e kompensimit nga neni 41 parografi (2) të këtij ligji (neni 28 parografi (9));
- 5) në programin për veprim me pajisje të hedhur nuk siguron masa për zbatim për sistemet për veprim me pajisjen e hedhur në pajtim me nenin 31 të këtij ligji dhe nuk e përpilon atë në bashkëpunim me prodhuesit pajisja e të cilëve është e përfshirë në sistem, si dhe në bashkëpunim me prodhuesit të kujdeset që programi të mirëmbahet dhe të jetë operativ (neni 31 parografi (4));
- 6) e pengon përfshirjen në sistem dhe me këtë e pengon zbatimin e programit nga neni 31 i këtij ligji, të prodhuesit i cili kryen import të pajisjes në Republikën e Maqedonisë ose nga prodhuesi kërkon plotësimin e kushteve tjera të cilat mund të paraqesin bariera tregtare ose prishje të konkurrencës në treg, me ç'rast prodhuesi i plotëson kushtet të cilat vlejnë edhe për prodhuesit vendorë të cilët janë të përfshirë në atë sistem (neni 33 parografi (3));
- 7) nuk ka ndërmarrë masa me të cilat sigurohet që përpunimi i pajisjes së hedhur të grumbulluar të bëhet në pajtim me nenin 35 paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij ligji dhe
- 8) nuk u dorëzon në kohë të caktuar raporte për veprim me pajisjen e hedhur prodhuesve në emër dhe për llogarinë e të cilëve është përgjegjës për veprim të drejtë me pajisjen e hedhur (neni 38 parografi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në vepruesin kolektiv me pajisjen e hedhur për veprimet nga parografi (1) i këtij neni.

(3) Kryerësit të kundërvajtjes nga parografi (1) pikat 1,2 dhe 3 të këtij neni mund t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar nga e cila del kundërvajtja në kohëzgjatje prej së paku tri ditë deri në më së shumti 30 ditë.

(4) Personit përgjegjës te personi juridik nga parografi (2) i këtij neni mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës nga e cila del kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku tri ditë deri në më së shumti 15 ditë.

## Neni 75

(1) Gjobë në shumë prej 20.000 deri në 35.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje vepruesit kolektiv, nëse:

- 1) nuk siguron leje për veprim me pajisjen e hedhur nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor (neni 28 parografi (2));
- 2) dorëzon raporte me të dhëna të pasakta me qëllim që të konstatohet se janë arritur qëllimet nga nenet 26 dhe/ose 35 të këtij ligji (neni 38) dhe
- 3) nuk i plotëson detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen vullnetare (neni 46).

(2) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në vepruesin kolektiv për veprimet nga parografi (1) i këtij neni.

(3) Kryerësit të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij mund t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar nga e cila del kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(4) Personit përgjegjës në vepruesin kolektiv nga paragrafi (2) i këtij neni, mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e detyrës nga e cila del kryerja e kundërvajtjes në kohëzgjatje prej së paku një vit deri në më së shumti pesë vjet.

## Neni 76

### Procedura për barazim dhe ndërmjetësim

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 70 dhe 73 të këtij ligji, organet për mbikëqyrje inspektuese nga neni 47 i këtij ligji detyrohen që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim para se të parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 71, 72, 74 dhe 75 të këtij ligji, organet për mbikëqyrje inspektuese nga neni 47 i këtij ligji, kryerësit të kundërvajtjes detyrohen t'i propozojnë procedurë për ndërmjetësim para se të parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(3) Në rastet në të cilat është arritur pëlqim për barazim, gjoba kryerësit mund t'i zvogëlohet më së shumti për gjysmën e gjobës së përcaktuar maksimale për kundërvajtje.

(4) Procedurat për barazim dhe ndërmjetësim udhëhiqen në pajtim me dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor dhe Ligjit për kundërvajtje.

## Neni 77

### Udhëheqja e procedurës për kundërvajtje

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 73 dhe 74 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Sferën e Mjedisit Jetësor në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Kundërvajtje), i formuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(2) Procedura në Komisionin për Kundërvajtje udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor.

(3) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 72 dhe 75 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe seksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

## VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

## Neni 78

### Afatet për realizim

(1) Regjistrimin e prodhuesve ekzistues të cilët lëshojnë në treg ose importojnë si shfrytëzues të fundit në Republikën e Maqedonisë pajisje në pajtim me ninen 13 të këtij ligji detyrohen ta bëjnë më së voni deri më 31 dhjetor 2013.

(2) Prodhesi, evidencën nga neni 38 paragrafi (7) i këtij ligji detyrohet të fillojë ta mbajë nga 1 janari 2014.

(3) Njoftimin e parë të prodhuesit nga neni 38 paragrafi (7) i këtij ligji për kategoritë dhe sasitë e pajisjeve që e lëshon në treg dhe që e importon në Republikën e Maqedonisë gjatë një viti kalendarik detyrohet ta dorëzojë më së voni deri më 31 mars 2015.

(4) Raportin e parë vjetor nga neni 38 paragrafi (1) i këtij ligji, vepruesi kolektiv dhe vepruesi i pavarur detyrohen ta dorëzojnë më së voni deri më 31 mars 2016.

(5) Prodhuesit në pajtim me detyrimet nga neni 21 i këtij ligji, detyrohen të bashkohen nëpërmjet themelimit dhe/ose lidhjes së marrëveshjes me vepruesin kolektiv për veprim me pajisje të hedhur ose të regjistrohen si veprues të pavarur me pajisje të hedhur më së voni deri më 31 dhjetor 2014.

(6) Detyrimet për shënimin e pajisjeve në pajtim me nenin 10 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2013. (7) Programi për menaxhimin me pajisje të hedhur nga neni 43 i këtij ligji do të miratohet më së voni deri më 31 dhjetor 2014.

## **Neni 79**

### **Dispozita kalimtare**

Dispozitat nga neni 10 i këtij ligji nuk kanë të bëjnë me pajisjen e lëshuar në treg para 1 janarit 2013.

## **Neni 80**

### **Zbatimi i kompensimeve dhe arritura e qëllimeve**

(1) Dispozitat e nenit 41 paragrafi (2) 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2015.

(2) Dispozitat e nenit 41 paragrafi (2) pika 8, të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2016.

(3) Qëllimet për grumbullim nga neni 26 i këtij ligji do të konsiderohen të arritura, nëse deri në vitin 2015 grumbullohet pajisje e hedhur nga ekonomitë familjare në sasi së paku 0,5 kilogram për banor.

(4) Qëllimet përpunim të pajisjes së hedhur nga neni 35 i këtij ligj për vitin 2015 do të konsiderohen të arritura, nëse:

1) për pajisje të hedhur që bën pjesë në kategoritë e pajisjeve nga neni 4 paragrafi (1) pikat 1 dhe 10 të këtij ligji realizohet, së paku:

a) shkalla e përpunimit prej 60% nga pesha mesatare e pajisjes dhe  
b) shkalla e rishfrytëzimit dhe riciklimit të pjesëve, materialeve dhe substancave prej 55 % nga pesha mesatare e pajisjes.

2) për pajisje të hedhur që bën pjesë në kategoritë nga neni 4 paragrafi (1) pikat 3 dhe 4 të këtij ligji realizohet, së paku:

a) shkalla e përpunimit prej 45% nga pesha mesatare për pajisje dhe  
b) shkalla e rishfrytëzimit dhe riciklimit të pjesëve, materialeve dhe substancave prej 35 % nga pesha mesatare për pajisje.

3) për pajisje të hedhur që bën pjesë në kategoritë e pajisjeve nga neni 4 paragrafi (1) pikat 2 dhe 5, 6 dhe 9 të këtij ligji realizohet, së paku:

a) shkalla e përpunimit prej 45% nga pesha mesatare për pajisje dhe  
b) shkalla e rishfrytëzimit dhe riciklimit të pjesëve, materialeve dhe substancave prej 40 % nga pesha mesatare për pajisje dhe

4) për pajisje të hedhur, poçë me zbrasje të gazi të nga Lista e llojeve të prodhimeve nga neni 41 paragrafi (4) të këtij ligji, së paku 45% rishfrytëzim dhe riciklim të pjesëve, materialeve dhe substancave nga pesha e prodhimit.

## **Neni 81**

## **Shpenzimet për veprimin me hedhurinat e mbetura**

(1) Me përjashtim të dispozitave nga neni 21 paragrafi (1) i këtij ligji për pajisjen që është lëshuar në treg deri më 1 janar 2013 (hedhurinë e mbetur), shpenzimet për veprim me pajisje të hedhur nga ekonomia familjare, i bartin proporcionalisht të gjithë prodhuesit me përpjesëtim me pjesën që i përgjigjet sasisë vjetore të pajisjes që e ka lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë.

(2) Për pajisjen e cila është lëshuar në treg deri më 1 janar 2013, shpenzimet për veprim me pajisje të hedhur (hedhurinat e mbetur) e cila nuk është e pajisje e hedhur nga ekonomia familjare i bartin prodhuesi dhe shfrytëzuesi i fundit për çka lidhin marrëveshje për financimin e veprimit me pajisje të hedhur që nuk është pajisje e hedhur nga ekonomia familjare.

### **Neni 82**

#### **Paraqitura e shpenzimeve për veprim me pajisje të hedhur**

Me përjashtim të dispozitave të nenit 22 paragrafi (2) të këtij ligji, shpenzimet për veprimin me pajisje të hedhur që krijojen nga kategoritë e pajisjeve nga neni 4 paragrafi (1) pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji, mund të paraqiten gjatë shitjes të pajisjes së re deri më 31 dhjetor 2017, e shpenzimet për veprimin me pajisjen e hedhur që krijojen nga kategoritë e pajisjes nga neni 4 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji, mund të paraqiten gjatë shitjes së pajisjes së re deri më 31 dhjetor 2018.

### **Neni 83**

#### **Fillimi i zbatimit**

(1) Dispozitat nga nenet 28 paragrafi (27) dhe 29 paragrafi (24) të këtij ligji do të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(2) Dispozitat e nenit 40 paragrafi (6) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian.

### **Neni 84**

#### **Miratimi i rregullave më të përafërtë**

Rregullat më të përafërtë për zbatimin e këtij ligji do të miratohen më së voni deri më nëntor 2013.

### **Neni 85**

#### **Shfuqizimi**

Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të shfuqizohen dispozitat e neneve 6 pika 13, 71, 71-a, 71-b, 127 paragrafi (1) pika 32 dhe 139 paragrafi (1), pika 24 të Ligjit për menaxhim me hedhurina ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 68/2004, 71/2004, 107/2007, 102/2008, 143/2008, 124/10 dhe 51/2011).

### **Neni 86**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare

të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet më 1 janar 2013.

**DISPOZITA NGA NJË LIGJ TJETËR**

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me pajisje elektrike dhe elektronike dhe me pajisje elektrike dhe elektronike të hedhur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

**Neni 15**

Rregullat e përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me pajisje elektrike dhe elektronike dhe me pajisje elektrike dhe elektronike të hedhur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

**Neni 16**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa nenet 8 (41-b paragrafi (3)), 10, 11 dhe 12 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 maji 2014.